



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT

6866/7
Nr. ____/Prot.

Tiranë, më 28.10.2025

URDHËR

Nr. 556, datë 28.10.2025

PËR

MIRATIMIN E PROGRAMEVE MËSIMORE TË DISA LËNDËVE TË
KURRIKULËS BËRTHAMË DHE TË KURRIKULËS ME ZGJEDHJE, TË
ARSIMIT TË MESËM TË LARTË

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të shkronjës “ç”, të pikës 2, të nenit 45 të ligjit nr. 69/2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të shkronjave “dh” dhe “e”, të pikës 5, të kreut III, të vendimit nr. 98, datë 27.02.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për krijimin, mënyrën e organizimit e të funksionimit të Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar (ASCAP)” dhe të urdhrit nr. 497, datë 29.09.2025 “Për delegimin e kompetencave dhe caktimin e detyrave të zëvendësministrit të Arsimit znj. Orjana Osmani”, i ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Miratimin e “Programit mësimor të lëndës “Gjuhë shqipe”, të kurrikulës bërthamë, për klasën e dhjetë të arsimit të mesëm të lartë”, sipas shtojcës 1, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij urdhri.
2. Miratimin e “Programit mësimor të përditësuar, të lëndës “Letërsi”, të kurrikulës bërthamë, për klasën e dhjetë të arsimit të mesëm të lartë”, sipas shtojcës 2, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij urdhri.
3. Miratimin e “Programit mësimor të përditësuar, të lëndës “Gjuhë angleze”, të kurrikulës bërthamë, për klasën e dhjetë të arsimit të mesëm të lartë”, sipas shtojcës 3, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij urdhri.
4. Miratimin e “Programit mësimor të lëndës “Qytetari”, të kurrikulës bërthamë, për klasën e dhjetë të arsimit të mesëm të lartë”, sipas shtojcës 4, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij urdhri.

5. Miratimin e "Programit mësimor të përditësuar, të lëndës "Histori", të kurrikulës bërthamë, për klasën e dhjetë të arsimit të mesëm të lartë", sipas shtojcës 5, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij urdhri.
6. Miratimin e "Programit mësimor të përditësuar, të lëndës "Gjeografi", të kurrikulës bërthamë, për klasën e dhjetë të arsimit të mesëm të lartë", sipas shtojcës 6, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij urdhri.
7. Miratimin e "Programit mësimor të përditësuar, të lëndës "Muzikë", të kurrikulës me zgjedhje, për klasën e dhjetë të arsimit të mesëm të lartë", sipas shtojcës 7, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij urdhri.
8. Miratimin e "Programit mësimor të përditësuar, të lëndës "Art pamor", të kurrikulës me zgjedhje, për klasën e dhjetë të arsimit të mesëm të lartë", sipas shtojcës 8, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij urdhri.
9. Miratimin e "Programit mësimor të përditësuar, të lëndës "Teatër", të kurrikulës me zgjedhje, për klasën e dhjetë të arsimit të mesëm të lartë", sipas shtojcës 9, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij urdhri.
10. Miratimin e "Programit mësimor të përditësuar, të lëndës "Edukim fizik, sport dhe shëndet", të kurrikulës bërthamë, për klasën e dhjetë të arsimit të mesëm të lartë", sipas shtojcës 10, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij urdhri.
11. Miratimin e "Programit mësimor të përditësuar, të lëndës "Matematikë", të kurrikulës bërthamë, për klasën e dhjetë dhe klasën e njëmbëdhjetë të arsimit të mesëm të lartë", sipas shtojcës 11, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij urdhri.
12. Miratimin e "Programit mësimor të përditësuar, të lëndës "Fizikë", të kurrikulës bërthamë, për klasën e dhjetë dhe klasën e njëmbëdhjetë të arsimit të mesëm të lartë", sipas shtojcës 12, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij urdhri.
13. Miratimin e "Programit mësimor të përditësuar, të lëndës "Kimi", të kurrikulës bërthamë, për klasën e dhjetë dhe klasën e njëmbëdhjetë të arsimit të mesëm të lartë", sipas shtojcës 13, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij urdhri.
14. Miratimin e "Programit mësimor të përditësuar, të lëndës "Biologji", të kurrikulës bërthamë, për klasën e dhjetë dhe klasën e njëmbëdhjetë të arsimit të mesëm të lartë", sipas shtojcës 14, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij urdhri.
15. Miratimin e "Programit mësimor të përditësuar, të lëndës "Gjuhë e huaj e dytë", të kurrikulës me zgjedhje, për klasën e dhjetë dhe klasën e njëmbëdhjetë të arsimit të mesëm të lartë", sipas shtojcës 15, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij urdhri.
16. Miratimin e "Programit mësimor të përditësuar, të lëndës "Edukim fizik, sport dhe shëndet", të kurrikulës me zgjedhje, për klasën e dhjetë dhe klasën e njëmbëdhjetë dhe klasën e dymbëdhjetë të arsimit të mesëm të lartë", sipas shtojcës 16, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij urdhri.
17. Programet mësimore të klasës së dhjetë hyjnë në fuqi dhe fillojnë zbatimin në vitin shkollor 2026 – 2027.
18. Programet mësimore të klasës së njëmbëdhjetë hyjnë në fuqi dhe fillojnë zbatimin në vitin shkollor 2027 – 2028.
19. Programet mësimore të klasës së dymbëdhjetë hyjnë në fuqi dhe fillojnë zbatimin në vitin shkollor 2028 – 2029.
20. Programet mësimore të mëparshme, shfuqizohen sipas fillimit të zbatimit të programeve mësimore të lëndëve në klasat e sipërcituara.

21. Ngarkohen për zbatimin e këtij urdhri, Sekretari i Përgjithshëm, Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit të Arsimit Parauniversitar, Agjencia Kombëtare e Arsimit Parauniversitar, Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar, drejtoritë rajonale të arsimit parauniversitar, zyrat vendore të arsimit parauniversitar dhe institucionet arsimore parauniversitare.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

ZËVENDËSMINISTRI

ORJANA OSMANI



PROGRAMI I LËNDËS “GJUHË SHQIPE” ARSIMI I MESËM I LARTË KLASA 10

FUSHA “GJUHËT DHE KOMUNIKIMI”

Koordinatore: Erida Koleci



PËRMBAJTJA


I. HYRJE	4
II. QËLLIMET DHE OBJEKTIVAT E LËNDËS SË GJUHËS SHQIPE.....	6
III. STRUKTURA E PROGRAMIT TË GJUHËS SHQIPE.....	8
IV. KOMPETENCAT DHE AFTËSITË QË ZHVILLON LËNDA E GJUHËS SHQIPE.....	10
4.1. Kompetencat kyç dhe rezultatet e të nxënit	10
4.2. Integrimi i temave ndërkurrikulare në lëndën e gjuhës shqipe	16
4.3. Kompetencat e lëndës së gjuhës shqipe	19
V. PËRMBAJTJA MËSIMORE DHE REZULTATET E TË NXËNIT.....	25
5.1. Ndarja e kohës mësimore për klasën e dhjetë	25
5.2. Përmbajtja mësimore e klasës së dhjetë.....	26
5.3. Shembuj veprimtarish për përmbushjen e rezultateve të të nxënit (RN-ve).	44
VI. SQARIME PËR LLOJET E TEKSTEVE	46
VII. UDHËZIME METODOLOGJIKE.....	47
7.1. Parimet e mësimdhënies së gjuhës shqipe	47

7.2.	Metodat dhe teknikat mësimore për zhvillimin e kompetencave gjuhësore	49
7.3.	Roli i projekteve kurrikulare në lëndën e gjuhës shqipe	51
7.4.	Lexuesi i shekullit XXI.....	52
7.5.	Puna me nxënësit me aftësi të kufizuara në lëndën e gjuhës shqipe.....	53
7.6.	Puna me nxënësit e talentuar në lëndën e gjuhës shqipe	55
7.7.	Puna me nxënësit që kanë vështirësi në gjuhën shqipe.....	56
VIII.	VLERËSIMI.....	57
8.1.	Shembuj të niveleve të arritjes për vlerësimin e rezultateve të të nxënit.....	59
IX.	BURIMET DHE MATERIALET MËSIMORE.....	60
9.1.	Përdorimi i teknologjisë në lëndën e gjuhës shqipe.....	61
9.2.	Roli i bibliotekës së shkollës.....	62
X.	REKOMANDIME PËR ZBATUESIT E PROGRAMIT	63
XI.	NDRYSHIMET PËRMBAJTJESORE.....	69

I. HYRJJE

Në një epokë të ndryshimeve të shpejta teknologjike dhe shoqërore, ku informacioni qarkullon me ritme të shpejta dhe kërkesat ndaj të nxënit ndryshojnë vazhdimisht, programet mësimore duhet të përditësohen për të përfshirë kompetencat që kërkon shoqëria bashkëkohore. Programi i lëndës së gjuhës shqipe për arsimin e mesëm të lartë u përgjigjet këtyre kërkesave, duke synuar pajisjen e nxënësve me njohuri dhe aftësi të thelluara për përdorimin e gjuhës shqipe si gjuhë amtare dhe zyrtare. Në qendër vendoset zhvillimi i kompetencave gjuhësore dhe kompetencave kyç, të lidhura ngushtë me kontekstin real të jetës. Përmes leximit, analizës, krijimit të teksteve dhe pjesëmarrjes në veprimtari që nxisin mendimin kritik dhe bashkëpunimin, nxënësit mësojnë të përdorin gjuhën shqipe në mënyrë të saktë, të vetëdijshme dhe krijuese. Ata ndërtojnë kështu një marrëdhënie të thellë me trashëgiminë kulturore kombëtare dhe përgatiten për pjesëmarrje aktive në jetën shoqërore dhe profesionale, duke ndjekur rrugën e të nxënit gjatë gjithë jetës.

Lënda e gjuhës shqipe bën pjesë në fushën “Gjuhët dhe komunikimi”. Në arsimin e mesëm të lartë, kjo fushë përbëhet nga lëndët e kurrikulës bërthamë “Gjuhë shqipe”, “Letërsi”, “Gjuhë angleze” dhe nga lëndët e kurrikulës me zgjedhje “Gjuhë shqipe me zgjedhje”, “Letërsi me zgjedhje” dhe “Gjuhë e huaj e dytë”. Të gjitha lëndët e kësaj fushe synojnë zhvillimin gjuhësor e letrar që është boshti themelor për rritjen intelektuale, shoqërore, estetike dhe emocionale të nxënësve.



Lënda e gjuhës shqipe ka një rëndësi të veçantë në kurrikulën e arsimit të mesëm të lartë. Ajo u ofron nxënësve mundësinë të përjetojnë fuqinë e gjuhës si mjet për të shprehur përvojat personale dhe për të kapërcyer pengesat gjuhësore që i ndajnë individët.

Nëpërmjet zhvillimit të kësaj lënde, nxënësit ndërtojnë dhe forcojnë kompetencat gjuhësore, me synimin që të bëhen qytetarë

kritikë, aktivë dhe të angazhuar në shoqëri. Ashtu si çdo lëndë tjetër, gjuha shqipe kontribuon edhe në zhvillimin e kompetencave kyç të përcaktuara

në Kornizën Kurrikulare të Arsimit Parauniversitar. Këto kompetenca janë të domosdoshme për formimin e një individi të aftë për të përmbushur me sukses kërkesat personale, shoqërore dhe profesionale të jetës bashkëkohore.

Ky qëllim realizohet përmes ndërtimit dhe zhvillimit të kompetencave specifike të lëndës. Bazuar në synimet dhe në përmbajtjen e lëndës, janë përcaktuar katër kompetenca të saj kryesore:

- Të dëgjuarit dhe të folurit për qëllime të ndryshme.
- Të lexuarit e teksteve të ndryshme.
- Krijimi i teksteve të ndryshme.
- Përdorimi i drejtë i gjuhës.

Ndërtimi i kompetencave kyç dhe lëndore nis që në arsimin bazë, ku nxënësit fitojnë njohuri, aftësi, vlera dhe qëndrime që u shërbejnë për jetën, mësimin e mëtejshëm dhe përgatitjen për tregun e punës. Në këtë vazhdimësi, arsimi i mesëm i lartë luan një rol kyç, pasi përkon me një fazë zhvillimi ku të rinjtë përballen me kërkesa më të larta dhe me sfida më komplekse, që lidhen me pavarësinë mendore, përgjegjësinë shoqërore dhe përdorimin e gjuhës në mënyrë të avancuar. Nxënësit kalojnë nga situatat e thjeshta të komunikimit të përditshëm drejt konteksteve më formale dhe të strukturuar, si: debatet, paraqitjet publike, shkrimet analitike apo projektet ndërkurrikulare. Ata mësojnë të përshtatin stilin dhe argumentimin sipas audiencës, të dëgjojnë në mënyrë aktive dhe të reflektojnë me mendim kritik për çështje të ndryshme. Po ashtu, theksi vihet tek aftësitë kërkimore dhe te përpunimi i informacionit nga burime të ndryshme, duke përfshirë mjediset digjitale. Kjo i ndihmon nxënësit të zhvillohen si përdorues të aftë të gjuhës dhe si pjesëmarrës të përgjegjshëm në jetën shoqërore. Ky zhvillim mbështetet nga një mësimdhënie e integruar, që lidhet me temat aktuale dhe me sfidat e së ardhmes, ku gjuha shihet si mjet kyç për të kuptuar botën dhe për të ndërtuar të ardhmen e tyre.

Ky program është hartuar për të ndihmuar mësuesit dhe nxënësit në zhvillimin e kompetencave gjuhësore dhe të kompetencave kyç, përmes një qasjeje të integruar, të bazuar në kompetenca dhe të përputhur me kërkesat e kohës.

II. QËLLIMET DHE OBJEKTIVAT E LËNDËS SË GJUHËS SHQIPE

Lënda e gjuhës shqipe ka për qëllim të pajisë nxënësit me njohuri, aftësi, vlera dhe qëndrime që u mundësojnë të zotërojnë gjuhën amtare dhe zyrtare me saktësi, fjalor të pasur dhe në përputhje me kontekstin. Përmes saj, nxënësit mësojnë ta përdorin gjuhën si mjet për të komunikuar, për të shprehur mendimet, ndjenjat dhe përvojat e tyre në mënyrë të argumentuar dhe krijuese. Ajo zhvillon aftësitë për të folur qartë, për të dëgjuar me vëmendje, për të lexuar në mënyrë kritike dhe për të shkruar me saktësi, në përputhje me normat gramatikore, drejtshkrimore dhe stilistike. Gjithashtu, lënda e gjuhës shqipe nxit ndërgjegjësimin gjuhësor dhe kulturor, duke i ndihmuar nxënësit të vlerësojnë trashëgiminë kombëtare dhe të kuptojnë rëndësinë e gjuhës shqipe në formimin e identitetit dhe në përgatitjen për sfidat e shoqërisë bashkëkohore.

Në lëndën e gjuhës shqipe, nxënësit e arsimit të mesëm të lartë:


- zhvillojnë dhe pasurojnë njohuritë gjuhësore dhe aftësitë komunikuese, duke i zbatuar ato në mënyrë të përshtatshme në situata mësimore, profesionale dhe digjitale;
- pasurojnë fjalorin (duke përfshirë terminologji nga fusha të ndryshme të dijes), përvetësojnë rregullat gramatikore, drejtshkrimore dhe të pikësimit, dhe i zbatojnë saktë në të folur dhe në të shkruar;
- shkruajnë me qartësi, logjikë, koherencë dhe në mënyrë krijuese, duke përshtatur gjuhën dhe stilin sipas qëllimit, lexuesit, kontekstit dhe mediumit (duke përfshirë platformat digjitale);
- kultivojnë një marrëdhënie të qëndrueshme dhe të vetëdijshme me leximin, si për kënaqësi, ashtu edhe për zhvillim personal e intelektual dhe për informim mbi botën që i rrethon;
- ushtrojnë aftësi të të folurit publik dhe të dëgjimit kritik, marrin pjesë në diskutime, debate dhe prezantime, duke demonstruar mendim kritik, etikë komunikimi dhe respekt për këndvështrime të ndryshme;
- analizojnë, interpretojnë dhe vlerësojnë tekste të larmishme, duke demonstruar mendim kritik dhe krijues për të nxjerrë kuptime, argumente dhe përfundime;

- përdorin strategji të leximit dhe të shkrimit për të menaxhuar, përpunuar dhe sintetizuar informacionin nga burime të ndryshme (përfshirë ato digjitale), duke ndërtuar qëndrime të pavarura dhe të përgjegjshme si qytetarë të informuar;
- zhvillojnë kompetenca digjitale dhe ndërkulturore, duke përdorur teknologjinë në mënyrë efikase për krijimin, përpunimin dhe shpërndarjen e përmbajtjeve gjuhësore dhe mediatike;
- përgatiten për sfidat e jetës në shekullin XXI, duke forcuar aftësitë komunikuese, bashkëpunuese, krijuese dhe të zgjidhjes së problemeve, si dhe duke ndërtuar vetëbesimin për të kontribuar si qytetarë aktivë, inovativë dhe përgjegjës.

Programi i gjuhës shqipe për klasën e dhjetë synon të zgjerojë gamën e kompetencave në të dëgjuar, të folur, të lexuar dhe të shkruar, të domosdoshme për sukses në shkollë dhe në jetën e përditshme. Nxënësit do të analizojnë tekste nga periudha bashkëkohore dhe historike, do të interpretojnë dhe do të vlerësojnë materiale informuese dhe grafike, si dhe do të krijojnë tekste gojore, të shkruara dhe mediatike në forma të ndryshme. Vëmendje e veçantë do t'i kushtohet përdorimit të strategjive të zgjedhura që mbështesin një komunikim të qartë, funksional dhe efektiv.

III. STRUKTURA E PROGRAMIT TË GJUHËS SHQIPE

Programi i gjuhës shqipe synon të krijojë kushte të favorshme për ndërtimin dhe zhvillimin e kompetencave të lëndës dhe të kompetencave kyç. Në thelb, ky program synon formimin e nxënësve si individë të aftë për të kuptuar, për të interpretuar dhe për të zbatuar njohuritë gjuhësore në mënyrë funksionale dhe të ndërgjegjshme në jetën e tyre të përditshme. Programi i lëndës së gjuhës shqipe në arsimin e mesëm të lartë ka këto rubrika:



- *Qëllimet dhe objektivat e lëndës:* Përcaktohen qëllimet dhe objektivat e lëndës për arsimin e mesëm të lartë.
- *Kompetencat kyç dhe rezultatet e të nxënit:* Tregohet mënyra se si kontribuon lënda në zhvillimin e kompetencave kyç përmes kompetencave të saj lëndore dhe paraqiten rezultatet e të nxënit të lidhura me to.
- *Temat ndërkurrikulare:* Shpjegohet roli i lëndës së gjuhës shqipe në integrimin e temave ndërkurrikulare, si: identiteti kombëtar dhe njohja e kulturave, qytetaria aktive dhe sipërmarrja, shëndeti mendor dhe fizik, zhvillimi i qëndrueshëm dhe mjedisi, teknologjia, shoqëria dhe media.
- *Kompetencat e lëndës dhe rezultatet e të nxënit:* Përshkruhen kompetencat lëndore dhe jepen rezultatet e të nxënit për çdo kompetencë.
- *Përmbajtja mësimore:* Në këtë rubrikë është përcaktuar koha mësimore në klasën e dhjetë dhe është sugjeruar një ndarje e numrit të orëve. Gjithashtu është dhënë zbërthimi i rezultateve të të nxënit në njohuri, aftësi, vlera dhe qëndrime.
- *Metodologjia e mësimdhënies:* Në këtë rubrikë pasqyrohen parimet që duhet të udhëheqin mësuesit në zbatimin e programit, metodat dhe teknikat që mund të përdoren për të zhvilluar kompetencat kyç dhe ato lëndore, puna me nxënësit me aftësi të kufizuara dhe me nxënësit e talentuar etj.
- *Vlerësimi i nxënësve:* Në këtë rubrikë përshkruhen në mënyrë të përmbledhur llojet e vlerësimit të nxënësit, shembuj të instrumenteve të vlerësimit etj. Gjithashtu ka edhe shembuj të niveleve të arritjes së rezultateve të të nxënit.
- *Burimet dhe materialet mësimore:* Në program janë përcaktuar disa nga burimet e të nxënit që mund të përdoren gjatë procesit mësimor, roli i teknologjisë së informacionit dhe të komunikimit, roli i bibliotekës së shkollës etj.
- *Rekomandime për zbatimin e programit:* Në këtë rubrikë jepen disa rekomandime për përdoruesit e programit lëndor, siç janë: mësuesit, hartuesit e teksteve mësimore, hartuesit e testeve kombëtare, vlerësuesit e jashtëm të cilësisë, prindërit dhe nxënësit.
- *Ndryshimet përmbajtjesore.* Në këtë rubrikë përshkruhen përditësimet kryesore në përmbajtjen lëndore, krahasuar me programin lëndor të mëparshëm.

IV. KOMPETENCAT DHE AFTËSITË QË ZHVILLON LËNDA E GJUHËS SHQIPE

Lënda e gjuhës shqipe ka rol të rëndësishëm në pajisjen e nxënësve me kompetencat gjuhësore dhe kompetencat kyç që u nevojiten për të përballuar sfidat e jetës shkollore, profesionale dhe shoqërore. Përmes saj, nxënësit mësojnë të komunikojnë në mënyrë të qartë e të argumentuar, të lexojnë e të interpretojnë tekste të ndryshme, të krijojnë mesazhe efektive dhe të përdorin gjuhën me saktësi, kreativitet dhe përgjegjësi.

Kjo rubrikë paraqet kompetencat dhe rezultatet e të nxënit që zhvillon lënda e gjuhës shqipe, duke treguar se si ato ndërthuren me kompetencat kyç të arsimit parauniversitar dhe me temat ndërkurrikulare, për të mbështetur formimin e plotë dhe gjithëpërfshirës të nxënësve.

4.1. Kompetencat kyç dhe rezultatet e të nxënit

Tregu i punës në të ardhmen do të kërkojë individë të aftë që të përshtaten me ndryshime të shpejta teknologjike, me automatizimin dhe sfidat e një ekonomie globale. Në këtë kontekst, nxënësit duhet të jenë të gatshëm të veprojnë me fleksibilitet, të ndryshojnë drejtimin e karrierës dhe të marrin pjesë në mënyrë aktive në jetën qytetare dhe profesionale në një shoqëri digjitale dhe të globalizuar.

Për t'u përballur me këto sfida dhe për të ndërtuar të ardhmen e tyre, është thelbësore që nxënësit të zhvillojnë kompetenca kyç dhe të kultivojnë një qasje të qëndrueshme ndaj të nxënit gjatë gjithë jetës. Këto kompetenca përbëhen nga një ndërthurje njohurish, aftësish, vlerash dhe qëndrimesh që i përgatisin për sukses në jetën personale, profesionale dhe shoqërore.

Në Kornizën Kurrikulare të Arsimit Parauniversitar janë përcaktuar tetë kompetencat kyç që synohen të ndërtohen dhe të zhvillohen në arsimin parauniversitar. Këto kompetenca janë:

1. Kompetenca e komunikimit në gjuhën amtare.
2. Kompetenca e komunikimit në gjuhë të huaja.
3. Kompetenca në matematikë, shkencë, teknologji dhe inxhinieri.
4. Kompetenca digjitale.
5. Kompetenca personale, shoqërore dhe e të nxënit.
6. Kompetenca qytetare.
7. Kompetenca e sipërmarrjes.
8. Kompetenca për vetëdijen dhe shprehjen kulturore.

Kurrikula krijon mundësi që nxënësit të zhvillojnë kompetencat kyç në përshtatje me moshën dhe me nivelin e klasës, gjatë gjithë viteve shkollore. Zhvillimi i këtyre kompetencave nuk ndodh në mënyrë të shkëputur, por është i ndërthurur ngushtë me procesin mësimor në të gjitha lëndët e kurrikulës. Ato përvetësohen përmes përfshirjes aktive të nxënësve në nivele të ndryshme: kognitive, emocionale, sociale dhe fizike.

Mësuesit luajnë një rol kyç në këtë proces, përmes përdorimit të metodave të ndryshme të mësimdhënies dhe të vlerësimit, duke krijuar një mjedis mësimor gjithëpërfshirës, të sigurt dhe të drejtë për të gjithë nxënësit. Për të lehtësuar zhvillimin dhe vlerësimin e kompetencave, ato janë të zbërthyera në rezultate të nxëni.

Në tabelën më poshtë paraqiten rezultatet që pritet të arrijë nxënësi në klasën e dhjetë në lëndën e gjuhës shqipe.

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kyç në klasën e dhjetë

Kompetenca e komunikimit në gjuhën amtare	Kompetenca e komunikimit në gjuhë të huaja
<i>Për të dëshmuar kompetencën e komunikimit në gjuhën amtare, nxënësi:</i> - komunikon si dëgjues, folës, lexues dhe shkruar në situata dhe për qëllime të ndryshme; - dallon dhe përdor lloje të ndryshme tekstesh, përfshirë edhe ato në formë digjitale (postime, mesazhe, faqe interneti); - shpreh mendimet dhe idetë e tij me gojë dhe me shkrim, duke i përshtatur sipas temës dhe dëgjuesit; - identifikon rëndësinë e gjuhës shqipe dhe vlerëson përdorimin e saj në ndërtimin e identitetit personal dhe kulturor; - përdor gjuhën për të krijuar ose për të kuptuar tekste që shprehin ndjenja dhe përvoja personale (tregime, poezi, ese); - paraqet mendimet e tij për një temë të caktuar para klasës ose një grupi, nëpërmjet së paku një forme komunikimi (me gojë ose me	<i>Për të dëshmuar kompetencën e komunikimit në gjuhë të huaja, nxënësi:</i> - komunikon në gjuhë të huaj duke bërë pyetje, duke krahasuar ide dhe duke dhënë sugjerime; - jep informacion dhe argumente për tema që lidhen me interesin e tij personal, shkollor apo profesional; - shkruan qartë për tema të ndryshme duke përmbledhur dhe duke vlerësuar informacionin nga burime të ndryshme; - përshkruan dhe paraqet shpjegime të thjeshta dhe të kuptueshme; - lexon, kupton dhe krijon tekste të ndryshme, përfshirë edhe ato digjitale; - përshtat mënyrën e të lexuarit sipas llojit të tekstit dhe përdor burime ndihmëse për kuptim; - vlerëson dhe respekton gjuhët dhe kulturat e vendeve të tjera; - kupton se kultura ndikon në mënyrën si përdoret gjuha dhe si bëhet

shkrim); - merr pjesë në biseda në grup duke dhënë mendime, duke argumentuar dhe duke bërë pyetje për temën që diskutohet; - shkruan duke respektuar rregullat drejtshkrimore të gjuhës shqipe në lloje të ndryshme tekstesh; - shpreh lirshëm qëndrimin e tij për tema të ndryshme nga jeta, shkenca, shoqëria apo mjedisi, duke përdorur gjuhë të përshtatshme dhe të qartë; - përdor programet e teknologjisë së informacionit (TIK) për të mësuar dhe për të përgatitur detyrat shkollore.	komunikimi; - shkruan duke respektuar rregullat e drejtshkrimit të gjuhës së huaj në tekste, si: ese, letra, <i>e-mail</i> etj.; - shpreh mendimin dhe qëndrimin e tij për tema nga jeta, shoqëria apo mjedisi, me gojë ose me shkrim; - përdor me efikasitet teknologjinë, aplikacionet digjitale dhe inteligjencën artificiale gjatë të nxënës.
Kompetenca në matematikë, shkencë, teknologji dhe inxhinieri	Kompetenca digjitale
<i>Për të dëshmuar kompetencat në matematikë, shkencë, teknologji dhe inxhinieri, nxënësi:</i> - zbaton njohuritë bazë matematikore në situata të përditshme, përfshirë edhe llogaritjet financiare; - kupton dhe shpjegon zgjidhjet matematikore në mënyrë të arsyetuar; - përdor gjuhën matematike për të komunikuar mendimet dhe zgjidhjet e tij; - interpreton dhe përdor të dhëna statistikore, tabela dhe grafikë. - përdor mjete dhe pajisje teknologjike në mënyrë të sigurt dhe të përshtatshme; - kryen eksperimente të thjeshta për të kuptuar dukuritë natyrore; - përdor të dhëna shkencore për të marrë vendime ose për të nxjerrë	<i>Për të dëshmuar kompetencën digjitale, nxënësi:</i> - përdor, përzgjedh, përpunon dhe vlerëson përmbajtje digjitale; - analizon të dhëna për të nxjerrë përfundime dhe për të marrë vendime të informuara; - zgjidh probleme të ndryshme duke përdorur mjete dhe platforma digjitale; - krijon, programon dhe shpërndan përmbajtje në format digjital; - menaxhon dhe mbron të dhënat personale, informacionin dhe identitetin digjital; - përdor mjete teknologjike për të kuptuar, për të organizuar dhe për të paraqitur informacione të ndryshme; - kupton përdorimin bazë të softuerëve dhe të pajisjeve teknologjike; - përdor inteligjencën artificiale për të analizuar të dhëna dhe për të zgjidhur

përfundime të mbështetura në prova; - shpjegon hapat që ndjek për të zgjidhur një problem brenda ose jashtë klasës; - analizon të dhënat e një projekti, i paraqet në forma tabelore ose grafike dhe nxjerr përfundime të arsyetuara; - kërkon informacion për një temë të caktuar, planifikon fazat e kërkimit dhe paraqet rezultatet duke përdorur grafikë dhe tabela; - identifikon burimet e informacionit dhe i përdor ato për të zgjidhur probleme të ndryshme; - vlerëson cilësinë e informacionit në një material të shkruar për një temë të caktuar, si ngrohja globale ose diversiteti kulturor; - shpjegon dhe argumenton rezultatet e një eksperimenti, duke përshkruar qëllimin, hipotezën, mënyrën e vëzhgimit dhe duke paraqitur përfundimet me tabela dhe grafikë.	probleme të thjeshta; - bashkëpunon me të tjerët përmes mjeteve digjitale për realizimin e detyrave dhe të projekteve; - përdor TIK-un për të ndërtuar tabela, grafikë, plane, tekste dhe prezantime të thjeshta; - komunikon dhe bashkëpunon me bashkëmoshatarët përmes platformave digjitale gjatë të nxënës; - prezanton një projekt duke përdorur figura, video, animacione ose skema për të shpjeguar një temë; - respekton rregullat e sigurisë digjitale dhe të privatësisë personale në përputhje me normat e etikës në komunikim.
Kompetenca personale, shoqërore dhe e të nxënës	Kompetenca qytetare
<i>Për të dëshmuar kompetencën personale, shoqërore dhe të të nxënës, nxënësi:</i> - identifikon përparësitë dhe dobësitë personale, përparon duke u mbështetur në përparësitë e tij dhe punon për kapërcimin e dobësive/mangësive; - organizon të nxënës, fokusohet dhe vendos qëllime; - vlerëson në mënyrë kritike punën e tij duke iu referuar qëllimeve fillestare;	<i>Për të dëshmuar kompetencën qytetare, nxënësi:</i> - angazhohet me të tjerët në çështjet publike; - tregon solidaritet dhe interes në zgjidhjen e problemeve në nivel shkolle dhe komuniteti; - vlerëson diversitetet dhe demonstroi tolerancë, mirëkuptim, respekt dhe qëndrim të hapur ndaj dallimeve; - demonstroi vlerat dhe parimet e të drejtave të njeriut në jetën e përditshme (p.sh.: respekti i dinjitetit personal, luftimi i paragjykimëve dhe diskriminimit

- motivon dhe vlerëson veten; - mëson dhe punon në mënyrë të pavarur dhe në bashkëpunim; - komunikon në mënyrë konstruktive dhe bashkëpunon në ekip; - kupton ndjenjat, mendimet dhe perspektivat e të tjerëve; - menaxhon stresin e pasiguritë dhe zgjidh konfliktet ndërpersonale; - kupton dhe analizon mënyrën e jetës së shëndetshme; - shfrytëzon, në mënyrë të duhur, këshillat dhe informacionet e marra për përkrahje në zgjidhjen e një detyre apo të një problemi të caktuar, pastaj rezultatet i paraqet para të tjerëve; - bën përpunimin e informacioneve për një temë të caktuar në mënyrë të pavarur dhe efektive, rezultatet e punës i prezanton me shkrim ose me gojë para të tjerëve, duke dhënë shpjegime për mënyrën e zgjedhjes së burimeve të informacionit; - harton një plan studimi (në formë skice, vizatimi, shkrimi etj.) për ndonjë çështje të caktuar, duke respektuar të gjithë hapat e planit të studimit dhe e paraqet para të tjerëve; - vlerëson, në mënyrë kritike, punën e vet duke iu referuar qëllimeve fillestare të punës, p.sh., në mënyrë të pavarur redakton një dorëshkrim të tij për përmirësimin e organizimit të shkrimit, qartësisë së mendimit etj.; - menaxhon, në mënyrë produktive, burimet që ka në dispozicion gjatë kryerjes së një aktiviteti ose të një detyre të caktuar në një lëndë mësimore apo në situata të jetës së përditshme.	- të të gjitha llojeve, promovimi i barazisë gjinore etj.); - menaxhon dhe zgjidh konfliktet në mënyrë të paanshme; - demonstroi sjellje etike dhe të përgjegjshme ndaj mjedisit dhe kontribuon në qëndrueshmërinë mjedisore; - harton një listë propozimesh për zbatimin e të drejtave themelore të njeriut në një situatë të caktuar, i kategorizon propozimet sipas rëndësisë, duke veçuar argumentet kryesore që mbështesin qëndrimin e vet; - prezanton, në forma të ndryshme, se si i ushtron të drejtat e veta në shkollë dhe në jetën e përditshme dhe si i njeh e i respekton të drejtat e të tjerëve, duke dhënë shembuj konkretë; - ilustron, me shembuj nga jeta e përditshme, praktikat e menaxhimit dhe të zgjidhjes së konflikteve në mënyrë konstruktive, duke ndarë me të tjerët përvojat, mendimet dhe ndjenjat e veta gjatë diskutimit të shembujve ilustrues në këtë fushë; - ilustron me shembuj zgjidhjen e problemeve të caktuara në nivel shkolle ose në nivel komuniteti, si dhe e arsyeton atë me argumente para një audience të caktuar (p.sh., demonstroi mënyrën e ofrimit të ndihmës së parë në rastet e fatkeqësive natyrore ose njerëzore); - merr pjesë në përgatitjen dhe në organizimin e një veprimtarie për mbrojtjen e mjedisit natyror dhe atij të krijuar nga njeriu dhe kontribuon në mënyra të ndryshme për zhvillimin e qëndrueshëm të tij.
---	---

Kompetenca e sipërmarrjes	Kompetenca për vetëdijen dhe shprehjen kulturore
<i>Për të dëshmuar kompetencën e sipërmarrjes, nxënësi:</i> - mendon në mënyrë strategjike dhe zgjidh probleme; - përdor imagjinatën e tij gjatë proceseve krijuese dhe novatore; - merr vendime financiare për koston dhe vlerën si dhe çmon koston e shndërrimit të një ideje në një aktivitet që krijon vlerë; - planifikon, merr dhe vlerëson vendimet financiare; - përballlet me pasigurinë, paqartësinë dhe rrezikun për vendimet që ndërmerr; - zbaton parimet e tregut të lirë dhe të buxhetimit në situata të jetës reale; - ndërmerr nisma në veprimtari të ndryshme me interes për lëndën/fushën mësimore, për klasën, për shkollën dhe për mjedisin ku jeton, si dhe tregohet i përgjegjshëm në plotësimin e detyrave, përmbushjen e detyrimeve dhe respektimin e afateve; - planifikon dhe menaxhon me sukses një projekt me objektiva të caktuar, si p.sh., një projekt për organizimin e ndërmarrjeve të vogla që ofrojnë produkte dhe shërbime për qytetarët, duke u mbështetur në kërkesat aktuale të tregut të punës; - përdor aftësitë digjitale për llogaritjen, analizën, interpretimin dhe paraqitjen e të dhënave me informacione të nevojshme (p.sh., të një biznesi); - zbaton udhëzimet dhe rregullat e shkruara në udhëzues, katalog apo	<i>Për të dëshmuar kompetencën për vetëdijen dhe shprehjen kulturore, nxënësi:</i> - njeh, respekton dhe çmon kulturën e tij si dhe vlerat, besimet dhe kulturat e të tjerëve; - shpreh dhe interpreton idetë, përvojat, emocionet figurative dhe abstrakte me ndjeshmëri në arte të ndryshme dhe në forma të tjera kulturore; - shijon dhe vlerëson veprat e artit; - shpreh veten në medie të ndryshme, duke përdorur dhe duke përmirësuar kapacitetin personal; - identifikon dhe realizon mundësitë për të shprehur vlera personale, sociale ose tregtare nëpërmjet arteve dhe formave të tjera kulturore.

skicë për përdorimin e drejtë të mjeteve laboratorike, makinave dhe pajisjeve teknike, gjatë një ushtrimi ose aktiviteti (në klasë, në laborator etj.), si dhe tregon për të tjerët mënyrën e zgjedhjes dhe të përdorimit të tyre.	
---	--

4.2. Integrimi i temave ndërkurrikulare në lëndën e gjuhës shqipe

Temat ndërkurrikulare janë përbërës të rëndësishëm të procesit mësimor që pasqyrojnë çështje aktuale dhe afatgjata me të cilat përballet shoqëria bashkëkohore. Ato janë të njëjta në të gjitha nivelet e arsimit parauniversitar dhe integrohen në të gjitha lëndët, për të ndihmuar nxënësit të kuptojnë më mirë lidhjet ndërmjet njohurive nga lëndë të ndryshme, të ndërtojnë një vizion të gjerë për botën dhe të marrin përgjegjësi në një mjedis global dhe shumë dinamik. Temat ndërkurrikulare, të cilat janë përcaktuar në kurrikulën bërthamë, janë:

- ✓ Identiteti kombëtar.
- ✓ Qytetaria aktive dhe sipërmarrja.
- ✓ Shëndeti mendor e fizik dhe siguria.
- ✓ Zhvillimi i qëndrueshëm.
- ✓ Teknologjia, shoqëria dhe media.

Lënda e gjuhës shqipe në arsimin e mesëm të lartë ka mundësi të shumta për trajtimin e këtyre temave përmes teksteve jolettrare, aktiviteteve të folurit dhe të shkruarit, si dhe analizës së përdorimit të gjuhës në kontekste bashkëkohore. Më poshtë paraqiten disa shembuj të trajtimit të secilës temë në lëndën e gjuhës shqipe.

Identiteti kombëtar: Gjuha shqipe përbën një nga shtyllat kryesore të identitetit kombëtar, pasi jo vetëm që shërben si mjet i përbashkët komunikimi mes shqiptarëve, por edhe ruan e transmeton trashëgiminë historike, kulturore dhe shpirtërore të kombit. Në lëndën e gjuhës shqipe, nxënësit ndërgjegjësohen për këtë rol përmes veprimtarive që i nxisin të vlerësojnë, të përdorin dhe të mbrojnë gjuhën si pasuri kombëtare. Nxënësit:

- diskutojnë rëndësinë e përdorimit të gjuhës standarde në institucionet shtetërore, në mediat publike dhe në jetën e përditshme, si një element i unitetit kombëtar;
- hartojnë materiale ndërgjegjësuere për shmangien e fjalëve të huaja, për pasurimin e fjalorit të shqipes dhe për përdorimin e saj të kujdesshëm në komunikimin shkollor, publik dhe digjital;
- studiojnë të folmet dialektore të shqipes për të vlerësuar larminë gjuhësore brenda kombit dhe për t'u ndërgjegjësuar për rëndësinë e gjuhës standarde si mjet i përbashkët për komunikim, bashkëjetesë kulturore dhe unitet kombëtar.

Qytetaria aktive dhe sipërmarrja: Lënda e gjuhës shqipe kontribuon në zhvillimin e aftësive të komunikimit publik dhe të ndërveprimit shoqëror, duke i pajisur nxënësit me aftësi gjuhësore për të shprehur mendime, për të argumentuar qëndrime dhe për të ndërmarrë veprime të përgjegjshme në jetën shoqërore. P.sh., në lëndën e gjuhës shqipe, nxënësit:

- hartojnë letra zyrtare, ftesa, kërkesa apo peticione për çështje që prekin jetën shkollore apo komunitetin lokal;
- përgatisin dhe paraqesin fjalime bindëse për tema shoqërore me interes për të rinjtë;
- marrin pjesë në debate për rolin e të rinjve në vendimmarrje dhe analizojnë rëndësinë e përdorimit të një gjuhe etike dhe argumentuese në komunikimin publik.

Shëndeti mendor e fizik dhe siguria: Lënda e gjuhës shqipe ofron mundësi për të trajtuar mënyrat se si ndikon gjuha në mirëqenien personale dhe në ndërtimin e një mjedisi të sigurt dhe mbështetës për të gjithë. Përmes komunikimit të kujdesshëm dhe të respektueshëm, nxënësit mësojnë të përdorin gjuhën si mjet për vetëvlerësim pozitiv, mbështetje emocionale dhe parandalim të konflikteve apo të rreziqeve në jetën reale dhe digjitale. P.sh., në lëndën e gjuhës shqipe, nxënësit:

- hartojnë broshura, postera apo mesazhe sensibilizuese që promovojnë shëndetin mendor dhe rëndësinë e përdorimit të gjuhës pozitive në klasë, familje dhe rrjete sociale;
- analizojnë situata komunikimi që ndikojnë në mirëqenien emocionale, duke dalluar përdorimin e fjalorit mbështetës, motivues dhe gjithëpërfshirës nga ai ofendues, përjashtues apo diskriminues;

- diskutojnë rreziqet e komunikimit në internet, si bullizmi online dhe përhapja e gjuhës së urrejtjes, ose hartojnë një udhëzues gjuhësor me rregulla për sjellje të sigurt dhe etike në hapësirën online.

Zhvillimi i qëndrueshëm: Lënda e gjuhës shqipe u jep nxënësve mundësinë të përdorin gjuhën si një mjet për të ngritur vetëdijen për çështjet mjedisore dhe për të ndikuar pozitivisht në qëndrimet dhe veprimet individuale e kolektive. Përmes të shkruarit dhe të folurit bindës, nxënësit përfshihen në forma të ndryshme komunikimi që nxisin përgjegjësinë dhe angazhimin për mbrojtjen e mjedisit, shoqërisë dhe ekonomisë. P.sh., nxënësit:

- shkruajnë ese për tema, si ndotja e ajrit, ndotja akustike, shfrytëzimi i burimeve natyrore apo ndryshimet klimatike, duke përdorur fakte dhe opinione që rrisin forcën argumentuese të mesazhit;
- hartojnë postera informues për fushata sensibilizuese në shkollë, duke eksperimentuar me përdorimin e gjuhës së figurshme, thirrjeve emocionale dhe fjalive të shkurtra që tërheqin vëmendjen e audiencës;
- përgatisin prezantime të shkurtra për praktikën e qëndrueshme në jetën e përditshme (p.sh.: kursimi i ujit, përdorimi i biçikletës, riciklimi), duke ushtruar të folurit argumentues dhe etikën e komunikimit publik;
- analizojnë mënyrën se si përdoret gjuha në fushata të ndryshme mediatike që synojnë të ndikojnë në sjelljen e qytetarëve ndaj mjedisit dhe konsumit.

Teknologjia, shoqëria dhe media: Në një realitet ku komunikimi ndodh kryesisht përmes teknologjisë dhe mediave digjitale, lënda e gjuhës shqipe luan një rol kyç në ndërtimin e aftësive për të kuptuar, për të analizuar dhe për të përdorur gjuhën në mënyrë kritike, etike dhe të përgjegjshme. Nxënësit mësojnë të zbulojnë qëllimin, tonin dhe ndikimin e gjuhës së përdorur në mediat tradicionale dhe ato sociale, si dhe të ndërtojnë vetë mesazhe të qarta, të ndershme dhe të përshtatshme për audiencën të ndryshme. P.sh., ata:

- analizojnë gjuhën e përdorur në lajme, tituj portalesh, reklama dhe rrjete sociale, duke identifikuar tendenca manipulimi, hiperbolizimi apo paragjykim;
- shkruajnë komente, postime ose reagime kritike ndaj përmbajtjeve mediatike, duke përdorur argumente dhe gjuhë etike që promovon respektin dhe mendimin e pavarur;


- diskutojnë sfidat dhe përgjegjësitë e komunikimit në mjedisin digjital.

Shënim. Veprimtari praktike të zhvillimit të temave ndërkurrikulare do të përshkruhen në udhëzuesit kurrikularë lëndorë.

4.3. Kompetencat e lëndës së gjuhës shqipe

Lënda e gjuhës shqipe zhvillon katër kompetenca, të cilat lidhen me kompetencat kyç që një nxënës duhet të zotërojë gjatë jetës së tij. Ndërtimi dhe zhvillimi i këtyre kompetencave synon përmbushjen e qëllimeve të lëndës së gjuhës shqipe.

Korniza konceptuale e lëndës së gjuhës shqipe



Kompetencat e lëndës së gjuhës shqipe

Kompetenca lëndore	Përshkrimi i kompetencës	Rezultatet e të nxënit
Të dëgjuarit dhe të folurit për qëllime të ndryshme	Për të ndërtuar këtë kompetencë, nxënësit përdorin gjuhën e folur si mjet kryesor për të komunikuar, për të shprehur mendime, ndjenja, përjetime dhe qëndrime, si dhe për të shqyrtuar ide e koncepte dhe për të zgjidhur probleme. Ata mësojnë të përshtatin të folurin sipas qëllimit, kontekstit dhe audiencës, duke ndërtuar mesazhe të qarta, të kuptueshme dhe të argumentuara. Dëgjimi aktiv dhe kritik është pjesë thelbësore e zhvillimit të kësaj kompetence. Nxënësit mësojnë të kuptojnë mesazhet e dëgjuara, të dallojnë qëllimin, strukturën, tonin dhe stilin e tyre, si dhe të reagojnë në mënyrë të menduar dhe të përshtatshme. Ky proces përfshin komunikimin ballë për ballë dhe ndërveprimet nëpërmjet materialeve digjitale, audio, video ose multimediale, që hasen në mjedise mësimore dhe jashtëshkollore. Përmes pjesëmarrjes në diskutime, debate, prezantime dhe forma të tjera të të folurit publik, nxënësit ushtrojnë të folurin dhe dëgjimin në mënyrë aktive. Ata ndërtojnë	Nxënësi: - komunikon me qartësi, saktësi dhe kreativitet, duke përshtatur stilin dhe gjuhën sipas dëgjuesit, qëllimit dhe kontekstit (shkollor, publik, digjital etj.); - dëgjon në mënyrë kritike dhe vlerëson tekste të folura apo multimediale, duke dalluar qëllimin, tonin dhe mesazhet; - merr pjesë aktivisht në diskutime, debate dhe prezantime, duke shprehur mendime të argumentuara dhe duke përdorur teknika bindëse të komunikimit; - bashkëpunon në mënyrë efektive në grupe, duke dëgjuar, duke ndarë ide dhe duke zgjidhur probleme në situata reale; - përdor mjetet dhe platformat digjitale për të folur, për të prezantuar dhe për të bashkëpunuar, duke respektuar normat etike të komunikimit online.

	mendimin kritik, aftësinë për të argumentuar dhe për të bashkëpunuar, duke u angazhuar në tema që lidhen me jetën personale, shkollore, kulturore dhe me çështje aktuale të shoqërisë.	
Të lexuarit e teksteve të ndryshme	Në arsimin e mesëm të lartë, kjo kompetencë zhvillohet përmes aftësimit të nxënësve për të kuptuar, interpretuar, analizuar dhe gjykyar në mënyrë të thelluar një gamë të gjerë tekstesh joletrare dhe letrare, digjitale dhe mediatike, që trajtojnë tema me përmbajtje kulturore, shoqërore, shkencore dhe qytetare. Nxënësit shkojnë përtej kuptimit të drejtpërdrejtë të përmbajtjes, duke zbatuar mendimin kritik, duke krahasuar burime dhe duke analizuar qëllimin, qëndrimin e autorit, strukturën, stilin, gjuhën dhe mesazhet e shprehura apo të nënkuptuara, në lidhje me kontekstin dhe ndikimin që ushtrojnë mbi lexuesin. Zhvillimi i kësaj kompetence përfshin edhe njohjen e llojeve të ndryshme të teksteve, vlerësimin e besueshmërisë së burimeve dhe reflektimin për mënyrën si përdoret gjuha për të ndërtuar mendime, qëndrime dhe perceptime, veçanërisht në mjediset digjitale dhe mediatike.	Nxënësi: - lexon, interpreton, analizon dhe gjykon tekste të ndryshme, përfshirë edhe ato digjitale ose mediatike, duke shpjeguar idetë kryesore, qëllimin dhe kuptimet dhe vlerat që ato përcjellin; - analizon gjuhën, stilin, figurat dhe mënyrën si është ndërtuar teksti, duke treguar se çfarë efekti kanë tek lexuesi; - krahason dhe kundërvë ide ose qëndrime nga tekste të ndryshme, duke i bashkuar ose dalluar përmes teknikave të krahasimit dhe përmbledhjes; - reflekton mbi procesin e leximit, duke dokumentuar zhvillimin e kuptimit përmes shënimeve, pyetjeve analitike ose skemave të organizimit konceptual.

	Kjo kompetencë mbështetet gjithashtu në zhvillimin e vetëdijes metakognitive, duke i ndihmuar nxënësit të ndjekin kuptimin gjatë leximit, të riformulojnë mendimet, të formulojnë pyetje analitike dhe të integrojnë informacione nga burime të ndryshme. Përmes leximit të qëllimshëm dhe kritik, nxënësit pasurojnë fjalorin, njohin dimensionet kulturore dhe etike të përmbajtjes dhe e përdorin informacionin në mënyrë të vetëdijshme në situata personale, mësimore dhe qytetare.	
Krijimi i teksteve të ndryshme	Në arsimin e mesëm të lartë, kjo kompetencë përfshin zhvillimin e aftësive për të krijuar tekste të ndryshme, duke marrë parasysh qëllimin, lexuesin dhe kontekstin. Nxënësit nuk mjaftohen me shkrimin e përmbajtjeve të thjeshta, por ushtrohen të ndërtojnë tekste të pasura në përmbajtje, me organizim të qartë, logjikë të brendshme, lidhje të natyrshme ndërmjet ideve dhe me gjuhë të saktë e të përshtatshme stilistikisht. Ata mësojnë të përdorin strategji të të shkruarit, që përfshijnë planifikimin, hartimin, rishikimin, redaktimin dhe përpunimin e tekstit, si dhe marrjen e komenteve dhe përmirësimin në bazë të tyre. Shkrimi bëhet një proces	Nxënësi: - krijon tekste të llojeve të ndryshme duke marrë parasysh qëllimin, lexuesin dhe kontekstin; - organizon idetë në mënyrë të qartë, logjike dhe të lidhur, duke përdorur gjuhë të saktë, të përshtatshme dhe stilistikisht të qëndrueshme; - zbaton hapat e të shkruarit (planifikim, hartim, rishikim, redaktim, përmirësim) dhe ndërton një stil origjinal të të shkruarit; - krijon tekste edhe nëpërmjet mjeteve digjitale dhe multimediale, duke ndërthurur tekst, imazh, tingull dhe grafikë për të përforcuar mesazhin;

	ndërveprues që nuk mbyllet me dorëzimin e produktit, por përfshin reflektimin mbi vetë mënyrat e të shkruarit, vetëvlerësimin dhe ndërtimin e një stili autentik dhe të përgjegjshëm. Kjo kompetencë përfshin edhe krijimin e përmbajtjeve përmes mjeteve digjitale, ku nxënësit ndërthurin elemente tekstuale, pamore, zanore dhe grafike për të përcjellë në mënyrë më të plotë dhe më bindëse idetë e tyre. Ata aftësohen të njohin dhe të respektojnë standardet etike të të shkruarit, përfshirë citimin e burimeve, shmangien e plagjiaturës, si dhe ndërtimin e mesazheve me ndikim në hapësirat publike dhe digjitale. Përmes zhvillimit të kësaj kompetence, nxënësit jo vetëm përvetësojnë njohuri dhe aftësi gjuhësore, por edhe ndërtojnë aftësi të të menduarit kritik, krijues dhe reflektues, duke u bërë krijues të pavarur dhe të përgjegjshëm në një shoqëri ku komunikimi shtrihet përtej formave tradicionale.	- respekton standardet etike të shkrimit: citon burimet, shmang plagjiaturën dhe ndërton mesazhe me ndikim dhe përgjegjësi në hapësirat digjitale; - demonstroi mendim kritik, krijues dhe reflektues gjatë krijimit të teksteve.
Përdorimi i drejtë i gjuhës	Për ndërtimin dhe zhvillimin e kësaj kompetence, nxënësi duhet të marrë njohuri, aftësi, vlera dhe qëndrime për të përdorur gjuhën shqipe në mënyrë të saktë, të qartë dhe të pasur, si në të folur, ashtu edhe në të shkruar. Kjo	Nxënësi: - përdor saktë trajtat e shumësit të emrave, emrat prejfoljorë, mbiemrat e emëruar dhe foljet e parregullta;

	kompetencë mbështetet në njohuritë dhe aftësitë për morfologjinë (trajtimi i fjalëve dhe i formave të tyre), sintaksën (funksioni sintaksor i fjalëve, ndërtimi dhe funksionimi i fjalive), leksikologjinë (pasuria e fjalorit dhe përdorimi i duhur i fjalëve), drejtshkrimin (zbatimi i normave të gjuhës standarde) dhe stilistikën (përshtatja e shprehjes sipas kontekstit dhe qëllimit). Kompetenca shtrihet jo vetëm në përvetësimin e njohurive rreth sistemit gjuhësor të shqipes, por kryesisht në përdorimin dhe zbatimin e këtyre njohurive, si dhe në zhvillimin e një vetëdijeje gjuhësore që ndihmon nxënësin të përcjellë mendime, emocione dhe mesazhe me qartësi dhe korrektësi.	- dallon dhe përdor përcaktorin kallëzuesor, rendin e gjymtyrëve të dyta, gjymtyrët homogjene dhe të veçuara, duke argumentuar funksionin e tyre sintaksor dhe stilistik; - identifikon shtresat leksikore (shqipe, huazime), përdor sinonime, antonime, shprehje frazeologjike dhe kuptime të figurshme për të pasuruar komunikimin me gojë dhe me shkrim; - zbaton rregullat drejtshkrimore për citimet, dialogun, nyjën e përparme dhe shkronjën e madhe; - dallon dhe përdor tiparet e gjuhës së folur dhe të shkruar, përdor parafrazën dhe siguron kohezion e koherencë në tekst.
--	--	--

V. PËRMBAJTJA MËSIMORE DHE REZULTATET E TË NXËNIT

5.1. Ndarja e kohës mësimore për klasën e dhjetë

Gjuha shqipe në klasën e dhjetë zhvillohet në dy orë mësimi në javë, gjithsej 72 orë mësimi në një vit shkollor. Koha mësimore përdoret:

- për ndërtimin e njohurive të reja;
- për ushtrime të orientuara drejt zbatimit të njohurive dhe përforcimit të të nxënës;
- për përsëritje dhe përforcim konceptesh;
- për testime;
- për ushtrime;
- për krijime esesh dhe punësh të tjera me shkrim;
- për vetëvlerësime dhe vlerësime të nxënësve për nxënësit;
- për projekte kurrikulare;
- për reflektime në lidhje me përparimin personal në të nxënë;
- etj.

Gjatë çdo ore mësimi në lëndën e gjuhës shqipe, nxënësit flasin, dëgjojnë, lexojnë, shkruajnë dhe fitojnë njohuri dhe aftësi rreth sistemit gjuhësor. Kjo do të thotë që çdo orë mësimi shërben për ndërtimin dhe zhvillimin e kompetencave lëndore. Orët e mësimi shërbejnë edhe për zhvillimin e kompetencave kyç.

Për lehtësi planifikimi sugjerohet që 20 orë mësimi të përdoren nga mësuesit:

- për përsëritje të përmbajtjes mësimore;
- për testime përmbledhëse;
- për zhvillimin e punëve me shkrim (ese, rrëfime, përshkrime etj.);


- për realizimin e projekteve kurrikulare e ndërkurrikulare.

Ndarja e kohës mësimore për klasën e dhjetë

Ndarjet kryesore	Orë mësimi të sugjeruara	Komente
Të folurit, të dëgjuarit dhe të lexuarit e teksteve përshkruese dhe rrëfyese, përfshirë edhe tekstet digjitale.	27	Koha mësimore shpërndahet në mënyrë të barabartë (afërsisht) ndërmjet llojeve të teksteve.
Përdorimi i drejtë i gjuhës <i>Morfologji, fjalëformim, sintaksë, drejtshkrim, pikësim dhe stilistikë</i>	25	Njohuritë dhe aftësitë në lidhje me sistemin gjuhësor të shqipes integrohen me studimin e teksteve përshkruese dhe rrëfyese, përfshirë edhe tekstet digjitale.
Përsëritje, testime, punë me shkrim, projekt.	20	Mësuesi e shpërndan kohën në funksion të ritmeve të të nxënit të nxënësve të klasës.
Gjithsej:	72	

5.2. Përmbajtja mësimore e klasës së dhjetë

Në programin e gjuhës shqipe janë paraqitur rezultatet e të nxënit për çdo kompetencë. Rezultatet e të nxënit janë pritshmëri të përgjithshme, të cilat shprehen në terma njohurish, aftësish, vlerash dhe qëndrimesh specifike për çdo klasë. Renditja e njohurive, aftësive, vlerave dhe qëndrimeve në program nuk nënkupton që përmbajtja mësimore gjatë vitit shkollor të zhvillohet në mënyrë të ndarë ose lineare sipas kësaj renditjeje. Kombinimi dhe organizimi i përmbajtjes mësimore në kapituj, tema apo njësi mësimore mbetet në kompetencën e mësuesve dhe të autorëve të teksteve shkollore, si përdoruesit kryesorë të programit.



Shënim. Tekstet që do të përzgjidhen për t'u punuar me nxënësit, mund të trajtojnë edhe tema, të tilla si:

- Prejardhja e gjuhës shqipe dhe vendi i saj në gjuhët indoeuropiane.
- Dokumentet dhe shkrimet e para në gjuhën shqipe dhe rëndësia e tyre për trashëgiminë kulturore.
- Kongresi i Manastirit dhe rëndësia e tij.
- Kongresi i Drejtshkrimit të Gjuhës Shqipe dhe sfidat e shkrimit të gjuhës shqipe sot.

Kompetenca: Të dëgjuarit dhe të folurit për qëllime të ndryshme	
Rezultatet e të nxënit për këtë kompetencë Nxënësi: - komunikon me qartësi, saktësi dhe kreativitet, duke përshtatur stilin dhe gjuhën sipas dëgjuesit, qëllimit dhe kontekstit (shkollor, publik, digjital etj.); - dëgjon në mënyrë kritike dhe vlerëson tekste të folura apo multimediale, duke dalluar qëllimin, tonin dhe mesazhet; - merr pjesë aktivisht në diskutime, debate dhe prezantime, duke shprehur mendime të argumentuara dhe duke përdorur teknika bindëse të komunikimit; - bashkëpunon në mënyrë efektive në grupe, duke dëgjuar, duke ndarë ide dhe duke zgjidhur probleme në situata reale; - përdor mjetet dhe platformat digjitale për të folur, për të prezantuar dhe për të bashkëpunuar, duke respektuar normat etike të komunikimit online.	
Njohuritë	Aftësitë
- Elementet e skemës së komunikimit dhe funksioni i tyre. - Paragjykimet dhe manipulimet në komunikim: si i dallojmë dhe si ndikojnë në kuptimin e mesazhit.	<i>Të dëgjuarit për të kuptuar dhe për të reflektuar</i> Nxënësi: - demonstroi të kuptuarit e mesazhit të dëgjuar, duke identifikuar idetë kryesore, argumentet mbështetëse dhe nënkuptimet; - mban shënime që tregojnë dëgjim të qëllimshëm dhe përqendrim;

- Etika e dëgjimit dhe e komunikimit në mjediset online: si ndërtojmë ndërveprime të përgjegjshme. - Llojet e teksteve për dëgjim: përshkrim i një vendi; prezantim i një personazhi historik; përshkrim i një kafshe, mjedisi ose objekti; tregim i lexuar me zë nga mësuesi apo një aktor; rrëfim personal në formë interviste audio/video; <i>blogje</i> të lexuara me zë (audio-blog); <i>podcast</i>-e etj. - Diskutimi formal: struktura dhe rolet e pjesëmarrësve në një diskutim. - Prezantimi efektiv: si përdorim mjetet vizuale dhe teknologjinë për të përforcuar mesazhin. - Zgjedhja e fjalëve dhe e mjeteve stilistike: hartimi i mesazheve të qarta dhe etike në kontekste të ndryshme, përfshirë ato digjitale.	- përmbledh dhe parafrazon informacionin e dëgjuar, duke e sintetizuar në mënyrë të qartë dhe të saktë; - shpreh mendim të argumentuar në diskutime, duke u bazuar në informacionin e dëgjuar; - reflekton për përmbajtjen e mesazhit, duke e lidhur me përvojat dhe njohuritë personale. <i>Të dëgjuarit për të vlerësuar</i> Nxënësi: - analizon qëllimin dhe kontekstin e mesazhit të dëgjuar; - vlerëson përmbajtjen, strukturën dhe përdorimin e elementeve joverbale (gjeste, mimikë, ton, intonacion); - dallon dhe interpreton fjalët e reja ose të panjohura nëpërmjet kontekstit; - vlerëson besueshmërinë e burimit, duke dalluar faktet nga opinionet dhe duke identifikuar paragjykime; - analizon ndikimin e gjuhës së përdorur mbi audiencën. <i>Të dëgjuarit në hapësira digjitale</i> Nxënësi: - dëgjon në mënyrë kritike dhe përzgjedhëse mesazhe në hapësira digjitale (video, <i>podcast</i>, rrjete sociale), duke dalluar informacionet e përshtatshme nga ato të panevojshme; - menaxhon përqendrimin dhe shmang shpërqendrimet gjatë dëgjimit në mjedise të mbingarkuara me informacione; - respekton etikën e dëgjimit në diskutime online: dëgjon me kujdes, nuk e ndërpret folësin, nuk përdor gjuhë ofenduese në reagimet e tij dhe përdor një ton të matur dhe të përgjegjshëm.
--	--

Komunikimi dhe gjuha gjatë të folurit

Nxënësi:

- identifikon dhe shpjegon rolin e elementeve të komunikimit gjatë të folurit (folësi, dëgjuesi, mesazhi, kanali, konteksti, qëllimi);
- zgjedh me kujdes fjalët, fjalitë dhe mjetet stilistike për të ndërtuar një mesazh të qartë, të bindshëm dhe të përshtatur sipas qëllimit, dëgjuesit dhe kontekstit;
- shpreh mendimet dhe ndjesitë e tij për tema të ndryshme dhe për dëgjues të ndryshëm;
- dallon veçoritë e gjuhës së folur, duke e krahasuar me gjuhën e shkruar (p.sh.: spontaniteti, elementet joverbale, ndërhyrjet, përsëritjet);
- vlerëson rolin e fjalës dhe të elementeve joverbale (gjeste, mimikë, toni i zërit, gjuha e trupit) në ndërtimin e një mesazhi të efektshëm;
- përdor intonacion, theks, ritëm, volum dhe pauza për të theksuar idetë kryesore dhe për të tërhequr vëmendjen e dëgjuesit.

Diskutimi dhe bashkëveprimi në grup

Nxënësi:

- merr pjesë në diskutime të ndryshme, duke përshtatur të folurin sipas qëllimit, temës dhe dëgjuesit;
- mbron qëndrimin personal, duke argumentuar mendimet e veta dhe duke respektuar rregullat e diskutimit (koha, rolet, rendi i fjalës);
- dallon dhe respekton rolet e grupit (moderator, drejtues, dëgjues) dhe bashkëpunon për të arritur një përfundim të përbashkët;

	- përdor gjuhë të qartë, të saktë dhe të pasur për të shprehur idetë, për të bërë pyetje dhe për të dhënë përgjigje të menduara; - analizon faktorët që ndikojnë në forcën e mesazhit (organizimi, toni, stili, për zgjedhja e fjalëve, këndvështrimi), duke ndërtuar mesazhe koherente dhe me ndikim. <i>Prezantimi me gojë</i> Nxënësi: - përgatit dhe realizon prezantime individuale për tema të ndryshme, duke paraqitur qëndrime personale të argumentuara (p.sh., debat rreth një problematike aktuale); - prezanton në grup projekte të përbashkëta, me ndarje të qartë rolesh dhe përgjegjësis; - përdor mjete pamore dhe digjitale për të mbështetur mesazhin; - përdor gjuhën verbale dhe joverbale për të mbajtur vëmendjen e audiencës dhe respekton kohën e prezantimit.
--	---

Vlerat dhe qëndrimet

Nxënësi:

- tregon respekt, ndjeshmëri dhe interes për bashkëbiseduesin, duke marrë parasysh këndvështrimet, bindjet dhe kulturën e tij;
- përfshihet në mënyrë aktive dhe të përgjegjshme në diskutime, debate dhe prezantime, duke kontribuar me ide, pyetje dhe reflektime;
- shpreh vetëbesim, seriozitet, sinqeritet dhe etikë në të folur, duke shmangur gjuhën fyese, paragjykimet dhe qëndrimet denigruese;
- përdor imagjinatën dhe kreativitetin për të zgjidhur probleme dhe për të ndërtuar mesazhe tërheqëse dhe me ndikim;
- menaxhon emocionet dhe situatat sfiduese gjatë të folurit publik, duke ruajtur qartësinë, përqendrimin dhe maturinë;
- shfrytëzon në mënyrë të vetëdijshme dhe të përgjegjshme teknologjinë e informacionit dhe të komunikimit për të përmirësuar prezantimet dhe ndërveprimet, si në hapësirat fizike, ashtu edhe në ato digjitale.

Kompetenca: Të lexuarit e teksteve të ndryshme

Rezultatet e të nxënit për këtë kompetencë

Nxënësi:

- lexon, interpreton, analizon dhe gjykon tekste të ndryshme, përfshirë edhe ato digjitale ose mediatike, duke shpjeguar idetë kryesore, qëllimin dhe kuptimet dhe vlerat që ato përcjellin;
- analizon gjuhën, stilin, figurat dhe mënyrën si është ndërtuar teksti, duke treguar se çfarë efekti kanë tek lexuesi;
- krahason dhe kundërvë ide ose qëndrime nga tekste të ndryshme, duke i bashkuar ose dalluar përmes teknikave të krahasimit dhe përmbledhjes;
- reflekton mbi procesin e leximit, duke dokumentuar zhvillimin e kuptimit përmes shënimeve, pyetjeve analitike ose skemave të organizimit konceptual.

Njohuritë	Aftësitë
- Teksti: përkufizimi i tij si njësi komunikimi me funksion dhe strukturë të caktuar; karakteristikat bazë të një teksti të ndërtuar mirë: qartësi, kohezion, qëllim dhe organizim logjik. - Elementet përbërëse të tekstit: tema, ideja kryesore, informacionet mbështetëse, renditja logjike dhe lidhja midis pjesëve të tekstit (kohezioni) etj.	Kuptimi i tekstit Nxënësi: - përdor strategji të strukturuar para, gjatë dhe pas leximit, si: vendosja e qëllimeve, parashikimi i përmbajtjes, aktivizimi i njohurive të mëparshme, formulimi i pyetjeve analitike, shënime reflektuese dhe krahasim perspektivash për të siguruar kuptimin e teksteve; - identifikon dhe përmbledh idetë kryesore dhe informacionet mbështetëse të teksteve të ndryshme; - shpjegon kuptimin e fjalëve e shprehjeve në kontekst, përfshirë edhe kuptimet e figurshme;

- Dallimet ndërmjet teksteve letrare dhe joletrare: struktura, qëllimi, gjuha e përdorur dhe ndikimi te lexuesi. - Karakteristikat dalluese të teksteve mediatike dhe digjitale në krahasim me ato tradicionale: ndërveprimi me lexuesin, përfshirja e përmbajtjes pamore dhe auditive, formati i shkurtër dhe tërheqës, përdorimi i hiperlinkeve etj. - Përdorimi i teknikave të leximit kritik: dallimi ndërmjet fakteve dhe opinioneve, identifikimi i qëllimit dhe i qëndrimit të autorit, analiza e nëntekstit dhe e ndikimit të gjuhës në mesazh. - Etika e leximit dhe e përdorimit të informacionit: respektimi i të drejtës së autorit, citimi korrekt i burimeve, shmangia e plagjiaturës dhe përdorimi etik i informacionit, veçanërisht në mjedise digjitale e mediatike.	- dallon mesazhet e drejtpërdrejta dhe të nënkuptuara, duke nxjerrë përfundime të mbështetura në tekst; - interpreton, analizon elementet pamore e grafike (fotografi, tabela, grafikë, harta), dhe shpjegon se si ato plotësojnë, mbështesin ose ndryshojnë kuptimin e tekstit të shkruar; - integron informacionin e marrë nga teksti i shkruar dhe nga elementet pamore ose multimodale për të ndërtuar një kuptim të plotë të tekstit.
Tekstet rrëfyese - Veçoritë strukturore dhe përmbajtjesore të teksteve rrëfyese: qëllimi për të treguar një	Analiza e elementeve të tekstit Nxënësi: - analizon strukturën e tekstit (hyrje, zhvillim, mbyllje, lidhjet logjike) dhe tregon si ajo ndihmon në kuptimin e mesazhit; - analizon mënyrën se si zhvillohen idetë, temat ose argumentet në tekst dhe si mbështeten nga shembujt e dhënë; - analizon zgjedhjet gjuhësore dhe stilistike të autorit (figura stilistike, ritmi, toni, regjistri), duke shpjeguar ndikimin e tyre mbi lexuesin; - shpjegon funksionin e elementeve pamore e multimodale (grafikë, foto, harta, video) në plotësimin ose zgjerimin e kuptimit të tekstit. Leximi kritik i tekstit Nxënësi:

ngjarje reale apo të trilluar në mënyrë të rrjedhshme, koherente dhe të kuptueshme. - Elementet përbërëse të një teksti rrëfyes: personazhet, ngjarjet, vendi, koha dhe renditja e tyre (kronologjike ose retrospektive), si dhe këndvështrimi rrëfyes (veta e parë ose e tretë). - Elementet gjuhësore ose stilistike të tekstit rrëfyes: përdorimi i foljeve në kohë të shkuar (e kryer e thjeshtë, e pakryer), i ndajfoljeve të vendit dhe të kohës, i lidhëzave, i dialogëve, si dhe i figurave stilistike që krijojnë emocion. Tekstet përshkruese - Veçoritë strukturore dhe përmbajtjesore të teksteve përshkruese: qëllimi për të përshkruar një objekt, person, vend apo ndjesi. - Elementet gjuhësore: përdorimi i mbiemrave, i emrave konkretë, i foljeve dhe i shqisave për të krijuar përfytyrim të gjallë te lexuesi. - Organizimi logjik i përshkrimit (nga e përgjithshmja tek e veçanta, nga jashtë brenda etj.).	- dallon faktet nga opinionet dhe vlerëson besueshmërinë e burimeve duke u mbështetur në argumente të bazuara në fakte; - analizon qëllimin dhe këndvështrimin e autorit dhe shpjegon se si ato ndikojnë në për zgjedhjen e përmbajtjes, gjuhës dhe tonit; - dallon mënyrat si përdoret gjuha për të bindur lexuesin dhe shpjegon si ato mund të përdoren për ta manipuluar, sidomos në tekstet mediatike e digjitale; - krahason tekste të ndryshme (letrare /joletrare, tradicionale/digjitale, rrëfyese/përshkruese) duke përdorur kritere të qarta si struktura, gjuha, funksioni, ndikimi te audienca etj.; - lidh tekstet e lexuara me forma të tjera artistike e mediatike (film, pikturë, muzikë, rrjete sociale etj.) për të nxjerrë ngjashmëri e dallime në trajtimin e ideve dhe mesazheve. Reflektimi dhe përdorimi i informacionit Nxënësi: - reflekton mbi idetë e lexuara dhe i lidh ato me përvojat personale, me aktualitetin dhe me situata të shoqërore e kulturore; - dokumenton procesin e leximit dhe të kuptimit (me shënime, ditar leximi, hartë mendore dhe grafikë krahasimi); - përdor informacionin e lexuar në mënyrë kritike e etike në punë me shkrim, projekte dhe prezantime, duke cituar burimet në mënyrë korrekte dhe duke shmangur plagjiaturën. Pasurimi i fjalorit
--	--

	Nxënësi: - përdor burime të ndryshme gjuhësore (fjalorë të shtypur dhe online, platforma digjitale, aplikacione gjuhësore) për të kërkuar dhe për të saktësuar kuptimin e fjalëve të panjohura; - shpjegon kuptimin dhe përdorimin e fjalëve dhe të shprehjeve të reja në tekstet rrëfyese dhe përshkruese, duke u mbështetur te konteksti; - analizon dhe përdor sinonime, antonime, polisemi, homonimi dhe shprehje frazeologjike për të shtuar saktësinë dhe pasurinë e shprehjes së tij; - shpjegon prejardhjen e fjalëve dhe zhvillimin e kuptimeve të tyre në kohë, duke i lidhur me përdorimin në kontekste të ndryshme tekstuale; - shpjegon rolin e gjuhës së figurshme në thellimin e kuptimit dhe në forcimin e mesazhit në tekste të ndryshme. Llojet e teksteve Nxënësi: - identifikon dhe përshkruan veçoritë dalluese të teksteve rrëfyese dhe të teksteve përshkruese, duke i dalluar nga llojet e tjera në bazë të qëllimit, strukturës dhe gjuhës së përdorur; - analizon funksionin, strukturën, përmbajtjen dhe gjuhën e një teksti rrëfyës, duke shqyrtuar elemente, si: personazhet, ngjarjet, renditja, mjedisi dhe këndvështrimi etj.; - analizon funksionin, strukturën, përmbajtjen dhe gjuhën e një teksti përshkrues, duke vënë në dukje renditjen logjike të përshkrimit, përdorimin e mbiemrave ose të shqisave për të krijuar imazhe të qarta te lexuesi;
--	--

	- krahason tekstet rrëfyese dhe tekstet përshkruese për të gjykuar ndryshimet në mënyrën e ndërtimit, në qëllim dhe në mënyrën se si ndikojnë te lexuesi; - vlerëson ndikimin e zgjedhjeve gjuhësore dhe stilistike në krijimin e atmosferës, emocioneve apo imazheve në të dyja llojet e teksteve.
--	--

Vlerat dhe qëndrimet

Nxënësi:

- shfaq motivim dhe kënaqësi për leximin, jo vetëm për qëllime mësimore, por edhe për zhvillim personal, kulturor dhe shoqëror;
- tregon vetëbesim dhe vetëvlerësim në aftësitë e veta për të kuptuar, për të analizuar dhe për të diskutuar rreth teksteve të ndryshme;
- respekton ide, qëndrime dhe këndvështrime që pasqyrohen në tekste të ndryshme;
- respekton të drejtën e autorit dhe shmang plagjiaturën kur përdor ose citon ide nga tekste të lexuara;
- vlerëson rolin e leximit kritik dhe informimit të saktë në ndërtimin e një mendimi të pavarur dhe në marrjen e vendimeve të përgjegjshme si qytetar i shekullit XXI;
- tregon vullnet dhe këmbëngulje për t'u përballur edhe me tekste të vështira;
- respekton të tjerët gjatë diskutimeve, dëgjon me kujdes dhe shmang paragjykimet.

Shënim. Nxënësi, përgjatë një viti shkollor, lexon dhe shkruan, pothuajse, të njëjtat lloje tekstesh. Sugjerohet që shkrimi i tekstit të realizohet me nxënësit, pasi është lexuar dhe studiuar ai lloj teksti nga nxënësi.

Kompetenca: Krijimi i teksteve të ndryshme

Rezultatet e të nxënit për këtë kompetencë

Nxënësi:

- krijon tekste të llojeve të ndryshme duke marrë parasysh qëllimin, lexuesin dhe kontekstin;
- organizon idetë në mënyrë të qartë, logjike dhe të lidhur, duke përdorur gjuhë të saktë, të përshtatshme dhe stilistikisht të qëndrueshme;
- zbaton hapat e të shkruarit (planifikim, hartim, rishikim, redaktim, përmirësim) dhe ndërton një stil original të të shkruarit;
- krijon tekste edhe nëpërmjet mjeteve digjitale dhe multimediale, duke ndërthurur tekst, imazh, tingull dhe grafikë për të përforcuar mesazhin;
- respekton standardet etike të shkrimit: citon burimet, shmang plagjiaturën dhe ndërton mesazhe me ndikim dhe përgjegjësi në hapësirat digjitale;
- demonstroi mendim kritik, krijues dhe reflektues gjatë krijimit të teksteve.

Njohuritë

- Procesi i të shkruarit, hapat dhe strategjitë e të shkruarit.
- Tekste përshkruese, si p.sh.: ese përshkruese, përshkrim i një personazhi, vendi, objekti apo ndjesie; përshkrim në formë artikulli apo postimi digjital me tekst dhe imazh.
- Tekste rrëfyese, si p.sh.: ese rrëfyese, rrëfim personal apo imagjinar, tregim i shkurtër me strukturë të qartë, postim rrëfyës në *blog* ose në rrjete sociale.

Aftësitë

Shkrimi si proces

Nxënësi:

- përcakton me qartësi qëllimin, temën dhe audiencën (lexuesin) e synuar (p.sh.: rrëfim personal, përshkrim i një vendi apo i një ngjarjeje etj.);
- planifikon shkrimin duke hartuar një strukturë paraprake dhe duke zgjedhur formatin më të përshtatshëm (tekst linear, me nënndarje, me elemente pamore etj.);
- mbledh dhe përzgjedh informacion nga burime të besueshme (fjalorë, artikuj shkencorë, materiale multimediale, burime online) duke respektuar të drejtën e autorit dhe etikën e citimit;
- ndjek të gjitha hapat e procesit të shkrimit: draftim - hartim - rishikim - redaktim - përpunim përfundimtar, duke u përqendruar si në përmbajtjen, ashtu edhe në formën gjuhësore;
- redakton shkrimin duke përmirësuar saktësinë, organizimin logjik, stilin e qartë dhe përdorimin e elementeve retorike për të bindur ose për të ndikuar lexuesin;

- përdor sugjerimet e të tjerëve (mësuesit, bashkëmoshatarëve, softuerëve ndihmës) për të reflektuar rreth versioneve paraprake dhe për të përmirësuar produktin përfundimtar;
- zbaton rregullat gramatikore dhe drejtshkrimore dhe shfaq kujdes në zgjedhjen e terminologjisë sipas kontekstit.

Shkrimi si produkt

Nxënësi:

- krijon tekste të organizuara në paragrafë, duke ndërtuar përmbajtje të qarta dhe të kuptueshme përmes rrëfimeve ose përshkrimeve të hollësishme;
- shkruan hyrje që prezantojnë në mënyrë tërheqëse temën ose personazhin, si dhe përfundime që mbyllin tekstin me koherencë dhe kuptim të plotë;
- zgjedh stilin dhe tonin sipas natyrës së tekstit dhe lexuesit;
- zbaton elemente strukturore për të siguruar rrjedhshmëri dhe kuptueshmëri, si p.sh.: renditja kronologjike e ngjarjeve, ndarja në pjesë, tituj ose nëntituj dhe lidhje të natyrshme mes paragrafëve;
- përshkruan personazhe, vende, ndjesi apo ngjarje, duke përdorur fjalor të pasur dhe të përshtatshëm;
- shfaq stil vetjak dhe përpiket të krijojë një zë të dallueshëm në të shkruar, duke përdorur me vetëdije mjete gjuhësore që gjallërojnë tekstin;
- përfshin elemente pamore, tinguj ose grafikë për të përforcuar përmbajtjen dhe për ta bërë komunikimin më tërheqës, kur shkruan në mjedise digjitale;

	- citon saktë burimet dhe respekton rregullat e të drejtës së autorit. <i>Llojet e teksteve që krijon nxënësi në klasën e dhjetë, janë:</i> - tekste përshkruese, si p.sh.: ese përshkruese, përshkrim i një personazhi, vendi, objekti apo ndjesie; përshkrim në formë artikulli apo postimi digjital me tekst dhe imazh; - tekste rrëfyese, si p.sh.: ese rrëfyese, rrëfim personal apo imagjinar, tregim i shkurtër me strukturë të qartë, postim rrëfyës në <i>blog</i> ose në rrjete sociale.
--	---

Vlerat dhe qëndrimet

Nxënësi:

- shfaq vetëbesim, këmbëngulje dhe vullnet për të përfunduar procesin e shkrimit, edhe kur përballlet me sfida;
- demonstroi imagjinatë, mendim krijues dhe fleksibilitet për të hartuar tekste të ndryshme;
- shkruan me përgjegjësi, duke respektuar të drejtën e autorit dhe duke shmangur plagjiaturën;
- respekton gjuhën standarde, por njih edhe përdorimin e ndërgjegjshëm të formave krijuese (p.sh., përdorimi stilistik i dialektit ose i zhargonit kur kërkohet nga konteksti);
- bashkëpunon me bashkëmoshatarët për të përgatitur projekte të përbashkëta me shkrim, duke ndarë ide dhe duke respektuar kontributin e secilit;
- është i hapur ndaj komenteve dhe sugjerimeve, duke i parë ato si mundësi për rritje dhe përmirësim të aftësive të veta shprehëse.

Shënim. Të gjitha njohuritë gjuhësore të lidhen me analizën dhe studimin e teksteve, jo si mësim të shkëputura gramatikore.

Përdorimi i drejtë i gjuhës

Rezultatet e të nxënësit

Nxënësi:

- përdor saktë trajtat e shumësit të emrave, emrat prejfoljorë, mbiemrat e emërzuar dhe foljet e parregullta;
- dallon dhe përdor përcaktorin kallëzuesor, rendin e gjymtyrëve të dyta, gjymtyrët homogjene dhe të veçuara, duke argumentuar funksionin e tyre sintaksor dhe stilistik;
- identifikon shtresat leksikore (shqipe, huazime), përdor sinonime, antonime, shprehje frazeologjike dhe kuptime të figurshme për të pasuruar komunikimin me gojë dhe me shkrim;
- zbaton rregullat drejtshkrimore për citimet, dialogun, nyjën e përparme dhe shkronjën e madhe;
- dallon dhe përdor tiparet e gjuhës së folur dhe të shkruar, përdor parafrazën, siguron kohezion e koherencë në tekst dhe përshtat shprehjen sipas kontekstit.

MORFOLOGJI DHE FJALËFORMIM*Sugjerohen 6 orë mësimi***Njohuritë**

- Emrat me dy trajta të shumësit.
- Emrat e dygjinishëm.
- Emrat prejfoljorë dhe përdorimi i tyre.
- Mbiemrat e emërzuar.
- Foljet e parregullta në mënyrat habitore dhe dëshirore.

Aftësitë**Nxënësi:**

- përdor në mënyrën e duhur trajtat e ndryshme të shumësit të emrave, duke argumentuar zgjedhjen e bërë;
- përshtat fjalët përcaktuese me emrat e dygjinishëm në numrin shumës dhe argumenton zgjedhjen e bërë;
- përcakton mënyrën e formimit të emrave prejfoljorë;
- analizon vlerën e përdorimit të emrave prejfoljorë në tekste të ndryshme;
- dallon emërzimin e mbiemrave;
- analizon vlerën e përdorimit të mbiemrave të emërzuar në tekste të ndryshme;

	- përdor foljet e parregullta në mënyrat habitore dhe dëshirore dhe argumenton zgjedhjen e bërë.
SINTAKSË <i>Sugjerohen 6 orë mësimi</i>	
Njohuritë	Aftësitë
- Përcaktori kallëzuesor dhe dallimi me përcaktorët e tjerë. - Rendi i gjymtyrëve të dyta (kundrinor, rrethanor, përcaktor, përcaktor kallëzuesor) në fjali. - Gjymtyrët homogjene. Gjymtyrët e veçuara.	Nxënësi: - përdor në fjali përcaktorin kallëzuesor; - dallon përcaktorin kallëzuesor nga përcaktorët e tjerë; - argumenton kur një fjalë ka funksionin e përcaktorit kallëzuesor; - përcakton rendin e gjymtyrëve të dyta në fjali; - analizon rendin e zakonshëm të gjymtyrëve të dyta dhe shpjegon rastet kur ky rend mund të ndryshojë për arsye stilistike; - përcakton llojin e gjymtyrëve homogjene (kryefjalë, kallëzues, kundrinor etj.); - argumenton kur janë gjymtyrë homogjene dhe kur nuk janë të tilla (kallëzuesi, përcaktorët etj.); - zgjeron fjalitë me gjymtyrë homogjene duke bërë përshtatjen e duhur me gjymtyrët e tjera të fjalisë; - shpjegon çfarë janë gjymtyrët e veçuara dhe cilat gjymtyrë mund të veçohen në fjali; - përdor gjymtyrë të veçuara (p.sh., përcaktorë, rrethanorë, kundrinorë) për të theksuar, për të shpjeguar ose për të qartësuar një pjesë të fjalisë; - analizon rolin sintaksor të gjymtyrëve të veçuara në ndërtimin e kuptimit të fjalisë; - përdor shenjat e pikësimit për të ndarë gjymtyrët e veçuara.
LEKSIKOLOGJI	

Sugjerohen 3 orë mësimi

Njohuritë	Aftësitë
- Shtresimi i leksikut sipas përdorimit dhe burimit (të shihen në rrafshin stilistik). - Sinonimet kontekstuale. Vargjet sinonimike. Antonimet kontekstuale.	Nxënësi: - dallon shtresat e leksikut sipas përdorimit dhe sipas burimit; - identifikon fjalët shqipe dhe huazimet sipas burimit; - analizon rolin stilistik të shtresave të ndryshme leksikore në ndërtimin e kuptimit dhe të efektit të tekstit; - përdor në mënyrë të vetëdijshme fjalë nga shtresa të ndryshme leksikore për të pasuruar shprehjen në të shkruar dhe në të folur; - vlerëson pasurinë leksikore të gjuhës shqipe; - shpjegon çfarë janë sinonimet kontekstuale dhe si dallohen nga sinonimet e zakonshme; - shpjegon çfarë janë vargjet sinonimike dhe si përdoren për të pasuruar gjuhën e folur dhe të shkruar; - analizon efektin stilistik që japin vargjet sinonimike në një tekst (si: forcimi i idesë, thellimi i emocionit ose shmangia e përsëritjeve të mërzitshme); - përdor sinonimet kontekstuale dhe vargjet sinonimike për të ndërtuar tekste më të pasura, të larmishme dhe me nuanca të sakta kuptimore; - shpjegon çfarë janë antonimet kontekstuale dhe si ndryshojnë nga antonimet e zakonshme; - jep shembuj të antonimeve që krijohen vetëm në varësi të kontekstit; - shpjegon efektin stilistik të antonimeve kontekstuale në forcimin e kontrastit në tekst.

DREJTSHKRIM DHE PIKËSIM

Sugjerohen 6 orë mësimi

Njohuritë	Aftësitë
- Drejtshkrimi i citimeve dhe i bibliografisë. - Drejtshkrimi në dialogë. - Drejtshkrimi i disa trajtave të shumësit të emrave dhe të mbiemrave. - Drejtshkrimi i nyjës së përparme. - Drejtshkrimi i shkronjës së madhe në emërtimet e festave dhe të ngjarjeve të veçanta, emërtimet e institucioneve, organizatave dhe titujve zyrtarë.	Nxënësi: - shpjegon rregullat drejtshkrimore në përdorimin e citimeve në tekst (p.sh.: thonjëzat, presjet, pikësimi brenda ose jashtë thonjëzave); - shpjegon si ndërtohet bibliografia në fund të një pune (autor-i/ët, titulli i veprës, shtëpia botuese, vendi, viti); - rendit burimet sipas standardeve (p.sh., alfabetike, sipas llojit të burimit); - zbaton rregullat drejtshkrimore për citimet dhe bibliografinë në përgatitjen e projekteve, punëve me shkrim etj.; - krahason ligjëratën e drejtë nga ligjërata e zhdrejtë duke evidentuar ndryshimet në strukturë, format gjuhësore dhe shenjat e pikësimit; - shndërron një fjali ose disa fjali nga ligjërata e drejtë në ligjëratën e zhdrejtë dhe anasjelltas, duke ruajtur kuptimin e saktë; - analizon efektin stilistik të përdorimit të ligjëratës së drejtë dhe të ligjëratës së zhdrejtë në një tekst letrar ose joletrar; - zbaton rregullat drejtshkrimore te dialogu; - krahason përdorimin e shenjave të pikësimit në dialog dhe në ligjëratën e drejtë; - zbaton rregullat drejtshkrimore për trajtat e shumësit të emrave dhe të mbiemrave; - zbaton rregullat drejtshkrimore për përdorimin e shkronjës së madhe në emërtimet e festave dhe të ngjarjeve të veçanta, emërtimet e institucioneve, organizatave dhe titujve zyrtarë.

STILISTIKË

Sugjerohen 4 orë mësimi

Njohuritë	Aftësitë
- Gjuha e folur dhe gjuha e shkruar. - Dialogu dhe monologu. - Parafraza. - Koherenca dhe kohezioni.	Nxënësi: - shpjegon dallimet kryesore midis gjuhës së folur dhe gjuhës së shkruar (p.sh.: spontaniteti, shprehjet joformale, gjestet dhe intonacioni te gjuha e folur; struktura e organizuar dhe korrektësia te gjuha e shkruar); - analizon situata komunikimi ku përdoret secila formë dhe shpjegon arsyet e përshtatjes së gjuhës me kontekstin; - reflekton për ndikimet e teknologjisë në gjuhën e folur dhe të shkruar; - dallon tiparet kryesore të dialogut dhe të monologut; - analizon rolin e dialogut dhe të monologut në tekste të ndryshme ose në komunikimin e përditshëm; - shpjegon çfarë është parafraza dhe ku përdoret (riprodhimi i një teksti ose mendimi me fjalë të tjera, pa ndryshuar kuptimin); - analizon dallimin midis citimit fjalë për fjalë dhe parafrazimit; - parafrazon duke rikrijuar tekste më të qarta, më të thjeshta ose të përshtatura për një audiencë të caktuar; - shpjegon çfarë janë koherenca (përshtatja logjike e ideve) dhe kohezioni (lidhja gjuhësore mes pjesëve të tekstit);

	- jep shembuj të elementeve gjuhësore që sigurojnë kohezionin (lidhëzat, përemrat, përsëritjet, sinonimet) dhe mënyrës si ndërtohet koherenca (renditja logjike e ideve); - analizon nivelin e kohezionit dhe të koherencës në tekste të ndryshme; - shkruan tekste duke zbatuar parimet e koherencës dhe të kohezionit.
Vlerat dhe qëndrimet	
Nxënësi: - tregon përgjegjësi dhe kujdes në përdorimin e gjuhës shqipe, duke respektuar rregullat drejtshkrimore, morfologjike dhe sintaksore; - vlerëson pasurinë dhe bukurinë e shqipes, duke e përdorur atë në mënyrë krijuese dhe të larmishme, si në kontekste formale, ashtu edhe joformale, përfshirë hapësirat digjitale; - tregon tolerancë dhe respekt për variante të ndryshme të shqipes (dialekte, të folme, përdorime kontekstuale), si pjesë e diversitetit gjuhësor; - demonstroi këmbëngulje në përmirësimin e shprehjes së vet dhe nuk ngurron të pranojë sugjerime, kritika ose reflektime për të rritur cilësinë e komunikimit të vet në të shkruar e në të folur; - përdor me përgjegjësi teknologjinë (aplikacione gjuhësore, mjete për korrigjim drejtshkrimor, platforma online) për të përmirësuar komunikimin me shkrim dhe me gojë.	

5.3. Shembuj veprimtarish për përmbushjen e rezultateve të të nxënëit (RN-ve).

Në këtë rubrikë ofrohen disa shembuj orientues veprimtarish që ndihmojnë për të përmbushur një rezultat të nxëni. Shembujt synojnë të ilustrojnë se si mund të realizohen aftësitë dhe rezultatet në procesin mësimor. Për hartimin e rezultateve të të nxënëit për orë mësimore, mësuesi bazohet në aftësitë e programit.

Dallimi mes aftësisë dhe rezultatit të të nxënëit:

- Aftësia është një deklaratë e përgjithshme që tregon çfarë duhet të zhvillojë nxënësi gjatë një periudhe më të gjatë (grup orësh, muaj, periudhë, vit). Pra, aftësia është e gjerë dhe afatgjatë (pasi kërkon kohë dhe sprova të vazhdueshme për t'u arritur) dhe përshkruan sjelljen e synuar. Shembull aftësie: *Nxënësi shkruan një tekst argumentues, duke ndërtuar tezë të qartë, argumente të mbështetura dhe përfundim bindës.*
- Rezultati i të nxënit për një orë mësimore është një deklaratë konkrete dhe e matshme që tregon çfarë do të arrijë nxënësi në fund të një ore specifike. Ai është i ngushtë dhe i përqendruar në një qëllim të qartë dhe bazohet në një pjesë të aftësisë së madhe nga programi. Shembull rezultati: *Nxënësi planifikon dhe harton strukturën e një eseje argumentuese për një temë të dhënë, duke përcaktuar tezën, argumentet dhe përfundimin.*

Rezultati i të nxënit	Veprimtaritë
<i>Nxënësi planifikon dhe harton draftin e një eseje rrëfyese.</i>	<i>Bisedë hyrëse (10 minuta)</i> - Mësuesi hap orën me një pyetje orientuese: <i>A keni ndonjë ngjarje që e kujtoni shpesh, sepse ju ka lënë mbresa?</i> - Diskutohet shkurtimisht se çfarë e dallon një tekst rrëfyese: një ngjarje konkrete, personazhe, kohë, vend, rend ngjarjesh dhe emocione personale. - Nxënësve u jepet liria të zgjedhin temën e rrëfimit për një ngjarje reale ose të trilluar. <i>Planifikimi i strukturës (10 minuta)</i> Nxënësit mund të zgjedhin një ngjarje për të rrëfyer dhe të planifikojnë tekstin e tyre përmes një flete pune që përfshin: - Titulli ose tema. - Koha dhe vendi i ngjarjes. - Personazhet. - Ngjarja kryesore dhe episodet e saj (sipas renditjes kronologjike ose retrospektive).

	- Emocionet dhe reflektimi personal. <i>Hartimi i draftit (20 minuta)</i> - Nxënësit fillojnë të shkruajnë draftin e esesë. Theksi vihet te qartësia, rrjedhshmëria, organizimi logjik dhe përfshirja e përjetimeve personale. - Mësuesi mbikëqyr punën dhe jep ndihmë sipas nevojës. <i>Mbyllja (5 minuta)</i> - Disa nxënës lexojnë një paragraf nga drafti i esesë së tyre. - Diskutim: <i>A ishte ngjarja e qartë? Çfarë ndjesish përcolli? Si mund të përmirësohet rrëfimi?</i> - Nxënësit përfundojnë esenë në orën e ardhshme.
--	--

Shënim. Në udhëzuesit kurrikularë për lëndën e gjuhës shqipe do të përshkruhen veprimtari praktike për përmbushjen e rezultateve të të nxënit.

VI. SQARIME PËR LLOJET E TEKSTEVE

Teksti është një element themelor në lëndën e gjuhës shqipe, pasi përmes tij nxënësit ndërtojnë dhe zhvillojnë jo vetëm kompetencat specifike të lëndës, por edhe kompetenca kyç, si: komunikimi, mendimi kritik, përdorimi i teknologjisë etj. Tekstet ose fragmentet e përzgjedhura në tekstin shkollor duhet të jenë të përshtatura me nivelin emocional, intelektual dhe social të nxënësve, si dhe me sfidat bashkëkohore me të cilat përballen ata.

Në klasën e dhjetë, nxënësit njihen me tekstet përshkruese dhe rrëfyese, duke kuptuar funksionin dhe qëllimin e tyre në situata të ndryshme komunikimi. Në klasat XI dhe XII, programi vijon me trajtimin e llojeve të tjera të teksteve.

Përveç teksteve të shkruara tradicionale, nxënësit punojnë edhe me tekste multimediale dhe digjitale, si video, *podcast*-e, *blogje*, apo përmbajtje nga rrjetet sociale, duke analizuar mënyrën se si ndikojnë gjuha, imazhi dhe tingulli në ndërtimin e përvojës dhe në transmetimin e mesazhit. Në lëndën e gjuhës shqipe, tekstet përdoren për të ndërtuar krahasime ndërmjet llojeve të ndryshme, për të analizuar përdorimin e gjuhës në kontekste të ndryshme dhe për të ushtruar krijimin e teksteve nga vetë nxënësit. Ndërsa analizat letrare zhvillohen në lëndën e letërsisë, në këtë lëndë fokusi është te kuptimi, vlerësimi, ndërtimi dhe përdorimi i teksteve joletrare, si dhe te krahasimi i tyre me tekstet letrare në aspektin gjuhësor dhe stilistik.

VII. UDHËZIME METODOLOGJIKE

Mësimdhënia e gjuhës shqipe bazohet në qasjen për zhvillimin e kompetencave gjuhësore të nxënësve. Në këtë rubrikë përshkruhen parimet, strategjitë dhe metodat që udhëheqin procesin e mësimdhënies. Qëllimi është të mbështetet zhvillimi i aftësive komunikative, mendimit kritik dhe të nxënësve të pavarur, duke marrë parasysh stilin dhe nevojat individuale të nxënësve, si dhe kërkesat e shoqërisë bashkëkohore.

7.1. Parimet e mësimdhënies së gjuhës shqipe

Për të siguruar një proces të suksesshëm të mësimdhënies së gjuhës shqipe në klasën e dhjetë, mësuesi duhet të udhëhiqet nga këto parime themelore:

Kontekstualizimi

Mësimi zhvillohet nëpërmjet situatave të kuptimit dhe reale, që lidhen me jetën e përditshme, përvojat personale dhe interesat e nxënësve. Tekstet dhe veprimtaritë mësimore zgjidhen në funksion të këtyre përvojave, duke kontribuar në pasurimin e fjalorit, përvetësimin e rregullave gramatikore dhe përdorimin e saktë të gjuhës në të folur dhe në të shkruar.

Integrimi i aftësive

Mësimdhënia ndërthur në mënyrë të natyrshme të dëgjuarit, të folurit, të lexuarit dhe të shkruarit, duke përdorur tekste të ndryshme për të ndërtuar njohuri dhe përvoja të ndërlidhura. Çdo aftësi mbështet dhe forcon tjetrën në mënyrë të vazhdueshme dhe funksionale.

Mësimdhënia me nxënësin në qendër

Procesi mësimor bazohet në nevojat, interesat dhe stilet e të nxënësve. Mësuesi diferencon materialet dhe metodat e punës për të siguruar përfshirjen aktive të çdo nxënësi dhe për të nxitur vetëvlerësimin dhe pavarësinë në të nxënë.

Orientimi drejt procesit

Theksi vihet te procesi i të nxënësve dhe jo vetëm te produkti përfundimtar. Mësuesi modelon hapat e punës (planifikimi, hartimi, rishikimi, përmirësimi) dhe udhëzon nxënësit gjatë hartimit të teksteve të ndryshme, duke i ndihmuar të reflektojnë për mënyrën se si shkruajnë dhe përdorin gjuhën.

Ndërveprimi i qëndrueshëm

Mësimi zhvillohet në një mjedis bashkëpunues dhe mbështetës, ku nxënësit nxiten të shprehen lirshëm, të dëgjojnë me kujdes, të respektojnë opinionet e të tjerëve dhe të ndërtojnë mendim kritik përmes dialogut. Kjo forcon vetëbesimin dhe zhvillon kompetencat lëndore dhe ato kyç.

Zhvillimi spiral

Njohuritë dhe aftësitë kthehen dhe thellohen në mënyrë të qëllimshme, duke i trajtuar në nivele të ndryshme kompleksiteti. Kështu, nxënësit forcojnë njohuritë bazë dhe përparojnë në mënyrë të qëndrueshme drejt aftësive dhe njohurive me nivel më të lartë vështirësie.

Qasja gjithëpërfshirëse

Mësimi përfshin dhe vlerëson të gjithë nxënësit, pavarësisht prejardhjes kulturore, sociale apo aftësive individuale. Mësuesi krijon një mjedis të drejtë, pozitiv dhe të hapur, ku çdo nxënës ndihet i përfaqësuar dhe i respektuar. Përfshirja e përvojave të ndryshme dhe pasqyrimi i diversitetit kulturor në përmbajtjet mësimore ndihmon në ndërtimin e një shoqërie demokratike dhe gjithëpërfshirëse.

7.2. Metodat dhe teknikat mësimore për zhvillimin e kompetencave gjuhësore

Zhvillimi i kompetencave gjuhësore kërkon nga mësuesi përzgjedhjen e metodave dhe të teknikave mësimore të përshtatshme. Këto metoda krijojnë një mjedis të larmishëm, bashkëpunues dhe aktiv për të nxënit, duke ndihmuar nxënësit të përmbushin në mënyrë të suksesshme rezultatet e të nxënit. Në tabelën e mëposhtme paraqiten disa nga teknikat dhe metodat më të përdorura për zhvillimin e këtyre kompetencave:

Metoda/ teknika	Të dëgjuarit	Të folurit	Të lexuarit	Të shkruarit
Stuhi mendimi	X	X		
Lexim i drejtuar		X	X	
Dëgjim i drejtuar (DLTA)	X	X		
Parashikim me terma paraprakë		X	X	
Lojë me role	X	X		
Rrjeti i diskutimit	X	X		
Kllaster		X	X	
Diagrami i Venit			X	X
Harta e konceptit			X	X
INSERT	X			X
Di /Dua të di/Mësova më shumë		X	X	X
Harta e mendjes	X		X	X
Pema e problemit	X		X	X
Diagrami piramidial			X	X
Ditari dypjesësh	X			X

Ruaje fjalën e fundit për mua	X		X	
Korniza të skeletëzuara të mësimi			X	X
Karrigia e nxehtë	X	X		
Imagjinata e drejtuar	X		X	
Dallimi i fakteve dhe i opinioneve	X	X	X	
Gjashtë kapelat për të menduarit	X			X
Shkrimi krijues me kufizime				X
Çfarë..., nëse...	X		X	
Tregimi pamor	X			X
Debati	X	X		

Zbatimi i këtyre teknikave dhe metodave mësimore mbështet zhvillimin e kompetencave gjuhësore, duke nxitur një gamë të gjerë aftësish që janë bazë për të nxënit në shekullin XXI. Nëpërmjet tyre, nxënësit aftësohen:

- të njohin, të kuptojnë, të analizojnë, të krahasojnë dhe të kategorizojnë përmbajtje të ndryshme;
- të shtrojnë pyetje të nivelit të lartë;
- të mbledhin, të vlerësojnë dhe të përzgjedhin informacion nga burime të besueshme;
- të shprehin mendime të argumentuara dhe t'i mbështesin me dëshmi e shembuj konkretë;
- të marrin parasysh perspektiva të ndryshme dhe të demonstrojnë empati;
- të zgjidhin probleme reale përmes një qasjeje të strukturuar;
- të mendojnë në mënyrë krijuese dhe të pavarur;
- të identifikojnë dhe të analizojnë shkaqet dhe pasojat e dukurive të ndryshme;

- të dallojnë faktet nga opinionet dhe të marrin vendime të informuara, bazuar në prova e arsyetim.

7.3. Roli i projekteve kurrikulare në lëndën e gjuhës shqipe

Projektet kurrikulare janë një formë e të nxënësve aktiv dhe të integruar që ndihmon nxënësit të zhvillojnë kompetencat gjuhësore dhe kompetencat kyçe përmes situatave kuptimplota dhe reale të të nxënësve. Në klasën e dhjetë, projektet për lëndën e gjuhës shqipe duhet:

- të lidhen me përvojat dhe interesat e nxënësve, si dhe me tema që kanë rëndësi në jetën e tyre të përditshme (komunikimi në rrjete sociale, përdorimi i gjuhës në publik, mënyrat e shprehjes në tekstet digjitale etj.);
- të zgjidhen dhe të zhvillohen në bashkëpunim mes mësuesit dhe nxënësve, duke marrë parasysh propozimet e tyre, pyetjet që shtrojnë dhe problemet që duan të eksplorojnë;
- të integrojnë aftësitë gjuhësore (të folurit, dëgjimin, leximin dhe shkrimin) në mënyrë funksionale, duke i përdorur ato për të hulumtuar, për të krijuar, për të komunikuar dhe për të reflektuar;
- të nxisin krijimtarinë, bashkëpunimin dhe përgjegjësinë, duke i angazhuar nxënësit si autorë, redaktorë, hulumtues, prezantues dhe kritikë të punës së tyre;
- të shërbejnë si mjet për vlerësim gjithëpërfshirës, në proces dhe në përfundim të produktit të projektit, ku nxënësi ndjek një proces të plotë: nga planifikimi deri te produkti përfundimtar dhe reflektimi për të.

Roli i mësuesit në këtë proces është të udhëheqë, të motivojë, të ndihmojë nxënësit të qartësojnë qëllimet, të strukturojnë punën, të organizojnë bashkëpunimin në grup dhe të ofrojnë mbështetje të vazhdueshme gjatë gjithë projektit, pa e marrë në dorë procesin.

Disa nga shembuj projektesh në gjuhën shqipe mund të jenë:

Podcast “Si flasim ne?”

Nxënësit realizojnë një seri episodesh të shkurtra në format audio, ku trajtojnë përdorimin e gjuhës në kontekste të ndryshme (familje, shkollë, media sociale), analizojnë shprehje të zakonshme, krahasojnë gjuhën formale dhe joformale dhe praktikojnë të folurin e strukturuar dhe të qartë për publik.

Fushatë ndërgjegjësuese “Flasim bukur, shkruajmë qartë”

Nxënësit hartojnë materiale ndërgjegjësuese (postera, video, shkrime) për përdorimin korrekt të gjuhës shqipe në rrjetet sociale, në komunikimin publik apo në mjedisin shkollor, duke analizuar gjuhën e përdorur në reklama, slogane, meme, tituj lajmesh etj.

Projekti “Gjuha e brezit tim”

Nxënësit mbledhin dhe analizojnë fjalë, shprehje, forma komunikimi të përdorura nga të rinjtë sot dhe i krahasojnë me gjuhën standarde. Produkti i përfunduar mund të jetë një fjalor i vogël ilustrativ ose një paraqitje multimediale, ku përforcohet ndërgjegjësimi gjuhësor dhe analiza gjuhësore.

Udhëzues “Si e përmirësojmë komunikimin në shkollë?”

Nxënësit hulumtojnë sfidat e komunikimit në mjedisin shkollor (nxënës–mësues, nxënës–nxënës, komunikimi digjital në grupe mësimore), analizojnë fjalorin, tonin dhe mënyrat e shprehjes, dhe propozojnë zgjidhje konkrete për përmirësimin e klimës komunikuese. Produkti i përfunduar mund të jetë një udhëzues i shkurtër i etikës gjuhësore në komunikimin shkollor.

Fushatë ndërgjegjësuese “Gjuha në shërbim të komunitetit”

Nxënësit identifikojnë një çështje në komunitetin lokal (si: ndotja, mungesa e informacionit për të rinjtë, keqinformimi online, mospërfshirja e të moshuarve në jetën sociale) dhe krijojnë materiale informuese në gjuhën shqipe: fletëpalosje, postera, video të shkurtra, përshkrime udhëzuese ose intervista, duke ushtruar njëkohësisht shkrimin funksional dhe vetëdijen qytetare.

7.4. Lexuesi i shekullit XXI

Në shekullin XXI, leximi nuk është më një aktivitet i izoluar, i kufizuar vetëm te libri i shtypur dhe përjetimi individual i tekstit. Sot, nxënësi-lexues jeton në një botë të mbushur me informacion, ku tekstet qarkullojnë përmes medimeve të ndryshme: librave, pajisjeve digjitale, rrjeteve sociale dhe materialeve multimediale. Ai nuk është më thjesht një marrës pasiv i përmbajtjes, por një pjesëmarrës aktiv, sepse analizon, reflekton, komenton, ndan dhe krijon kuptim në bashkëbisedim me të tjerët.

Në këtë realitet të ri, programi dhe mësimdhënia e gjuhës shqipe duket t’u krijojnë mundësi nxënësve të zhvillojnë aftësi jo vetëm për të kuptuar tekstin e shkruar, por edhe për të lundruar mes llojeve të ndryshme të teksteve (letrare dhe jolettrare, të shtypura dhe digjitale), për të zhvilluar

mendimin kritik dhe për të mbajtur qëndrim ndaj ndikimit të mediave. Formimi i një lexuesi të aftë, reflektues dhe të vetëdijshëm është një nga qëllimet kryesore të lëndës së gjuhës shqipe.

Tiparet e lexuesit të shekullit XXI

Lexuesi i shekullit XXI rritet dhe formësohet brenda një bote digjitale, të ndërlidhur dhe shumëkulturore. Ai nuk është më thjesht një konsumues i librave të shtypur, por një përdorues i shumëfishtë i burimeve të ndryshme të informacionit.

Sot, lexuesi ndërthur leximin tradicional me format të reja: libra elektronikë, audiolibra, artikuj online, *blogje*, rrjete sociale dhe platforma multimediale. Ai lëviz natyrshëm mes gjuhëve të ndryshme, kulturave dhe gjinive, duke pasuruar përvojën e vet të leximit me ndikime globale dhe ndërkulturore.

Një nga tiparet më dalluese është aftësia për të ndërvepruar me tekstin. Lexuesi i shekullit XXI e sheh tekstin si një hapësirë për diskutim, jo si të vërtetë absolute. Përmes komenteve online, *blogjeve*, rishikimeve dhe rrjeteve sociale, ai bëhet pjesë aktive e qarkullimit të ideve. Në të njëjtën kohë, lexuesi i shekullit XXI është shpesh i shpërqendruar, i mësuar me lexime të shpejta dhe të fragmentuara. Titujt, përmbledhjet dhe lajmet e shkurtra marrin më shumë vëmendje sesa tekstet e gjata e të thelluara, duke krijuar sfida për zhvillimin e aftësisë së leximit të thellë dhe reflektues. Ky lexues është gjithashtu një kërkues i përvojave personale: ai lexon jo vetëm për informim apo argëtim, por edhe për zhvillim personal, mirëqenie emocionale dhe kuptim të vetes. Librat motivues, historitë e vërteta dhe rrëfimet personale zënë një vend të rëndësishëm në leximet e tij.

Në aspektin edukativ, lexuesi i sotëm e konsideron leximin si pjesë të të nxënies gjatë gjithë jetës. Ai kërkon të përmirësojë aftësitë e veta profesionale, të qëndrojë i përditësuar me zhvillimet e reja dhe të zgjerojë horizontet e veta përmes leximit.

Një element jetik është ndërgjegjësimi për ndikimin mediatik: lexuesi i shekullit XXI ka nevojë të dallojë informacionin e vërtetë nga lajmet e rreme, të zhvillojë mendimin kritik dhe të jetë një përdorues i kujdesshëm i burimeve.

7.5. Puna me nxënësit me aftësi të kufizuara në lëndën e gjuhës shqipe

Puna me nxënësit me aftësi të kufizuara në klasën e dhjetë kërkon një mësimdhënie të diferencuar dhe gjithëpërfshirëse, e cila merr parasysh nevojat individuale dhe potencialin e çdo nxënësi për zhvillim gjuhësor, komunikues dhe shoqëror. Procesi fillon me njohjen e specifikave të nxënësit dhe me hartimin e një plani edukativ individual (PEI), në bashkëpunim me mësuesin ndihmës, psikologun, stafin pedagogjik të shkollës dhe, kur është e nevojshme, me qendrën burimore.

Në lëndën e gjuhës shqipe, mësuesi synon të zhvillojë aftësitë gjuhësore dhe të komunikimit në mënyrë të arritshme dhe kuptimplote për çdo nxënësi. Kjo realizohet përmes:

- përshtatjes së materialeve mësimore, si tekste të thjeshtuara, me shkronja të mëdha, me figura ose versione audio/vizuale;
- përzgjedhjes së detyrave të personalizuar, që lidhen me nivelin e kuptimit dhe me mënyrën e të nxënësit të nxënësit;
- krijimit të një klime mbështetëse që inkurajon vetëbesimin dhe pjesëmarrjen aktive në klasë;
- përdorimit të teknologjisë ndihmëse, si aplikacione për të folur, për të shkruar ose për të kuptuar tekstin;
- integritit të metodave multisensore që përfshijnë dëgjimin, shikimin dhe ndërveprimin praktik për të përforcuar të nxënësit;
- përdorimit të gjuhës së thjeshtë dhe të shembujve konkretë që e bëjnë përmbajtjen më të kuptueshme;
- përfshirjes së bashkëmoshatarëve në punën në grupe të vogla ose me ndihmë të drejtpërdrejtë, duke nxitur ndërveprimin social dhe bashkëpunimin.

Shembuj veprimtarish të përshtatura për klasën e dhjetë:

- Analizë e teksteve të thjeshtuara, me diskutime për temat kryesore.
- Dëgjim tregimesh, esesh të shkurtra ose intervistash, të ndjekura nga ushtrime ose pyetje me alternativa ose me përgjigje të shkurtër.
- Përshkrimi me fjalë të thjeshta ose me ndihmën e vizatimeve/fotografive të vendeve, i ngjarjeve ose i ndjesive.
- Hartimi i fjalëve të thjeshta, i përshkrimeve të shkurtra ose i opinioneve për tema të ditës, me ndihmë nga mësuesi ose me përdorimin e mjeteve teknologjike.
- Përdorimi i skemave vizuale (harta mendore, tabela krahasuese) për të organizuar idetë para shkrimit.
- Lojë me role apo veprimtari të tjera, për të praktikuar të folurit dhe dëgjimin në situata të jetës së përditshme.

7.6. Puna me nxënësit e talentuar në lëndën e gjuhës shqipe

Nxënësit e talentuar në lëndën e gjuhës shqipe shfaqin aftësi të theksuara në të menduarit kritik, në zotërimin e strukturave gjuhësore, në analizimin e përdorimit të gjuhës në kontekste të ndryshme dhe në krijimin e teksteve joletrare të qarta, të argumentuara dhe origjinale. Përfshirja dhe mbështetja e tyre është e rëndësishme për të nxitur zhvillimin e potencialit të tyre, si dhe për të krijuar një mjedis mësimor më sfidues dhe më cilësor.

Përfitimet e mbështetjes së nxënësve të talentuar:

- Nxënësit e talentuar kanë nevojë për detyra që përmbajnë sfida të reja dhe kërkojnë përdorim më kompleks të gjuhës.
- Përfshirja në veprimtari të avancuara rrit motivimin e tyre dhe ndihmon në thellimin e kompetencave gjuhësore.
- Këta nxënës mund të japin kontribut të çmuar në punën në grup, në debate dhe në projekte të ndryshme në shkollë.
- Veprimtaritë që synojnë zhvillimin e tyre individual, mund të ndikojnë pozitivisht në nivelin e të gjithë klasës.

Si mund të identifikohen nxënësit e talentuar në këtë lëndë?

- Tregojnë saktësi dhe kreativitet në të shkruar dhe në të folur.
- Zotërojnë terminologji të pasur dhe përdorin struktura gjuhësore të ndërlikuara.
- Janë të aftë të analizojnë funksionin dhe efektin e gjuhës në media, në tekste joletrare apo në komunikimin institucional.
- Shfaqin interes të qëndrueshëm për mënyrat se si funksionon gjuha në kontekste të ndryshme: sociale, akademike, digjitale etj.
- Reagojnë shpejt ndaj sfidave gjuhësore dhe janë të gatshëm të ndërmarrin detyra më komplekse.

Forma mbështetjeje për nxënësit e talentuar në lëndën e gjuhës shqipe:

- Detyra analitike për të krahasuar përdorimin e gjuhës në lloje të ndryshme tekstesh (p.sh.: artikull informues, ese argumentuese, postim në rrjet social).
- Përgatitja e fjalimeve, prezantimeve ose *podcaste*-ve për tema aktuale që kërkojnë qartësi në të shprehur dhe argumentim të thelluar.

- Punë individuale me kërkime gjuhësore, si: analiza e fjalorit në një tekst mediatik, përdorimi i toneve dhe stilit apo ndikimi i gjuhës në perceptimin e publikut.
- Udhëheqja e projekteve për ndërgjegjësim për përdorimin etik të gjuhës në media dhe në rrjete sociale.
- Pjesëmarrja në konkurse që lidhen me përdorimin e gjuhës (ese, gara ose konkurse të të folurit, krijim broshurash informuese, fushata ndërgjegjëse).
- Nxitja për të krijuar tekste origjinale në formate të ndryshme (artikuj, intervista, tekste për prezantime, letra të hapura, komunikime për median etj.).

7.7. Puna me nxënësit që kanë vështirësi në gjuhën shqipe

Në klasë mund të ketë nxënës që kanë vështirësi në zotërimin e gjuhës shqipe për arsye të ndryshme: mund të jenë nxënës të kthyer nga emigracioni, nxënës që vijnë nga familje me gjuhë të tjera amtare, ose nxënës që nuk kanë pasur ekspozim të vazhdueshëm ndaj gjuhës shqipe të shkruar dhe të folur. Për të mbështetur mësimdhënien gjithëpërfshirëse dhe për të siguruar barazi në të nxënë, mësuesi duhet të planifikojë dhe të zbatojë strategji të diferencuara mësimore që i ndihmojnë këta nxënës të ndërtojnë dhe të zhvillojnë kompetencat gjuhësore.

Objektivat kryesorë të mbështetjes:

- Zvogëlimi i hendekut gjuhësor mes nxënësve që kanë vështirësi dhe të tjerëve.
- Zhvillimi gradual i aftësive gjuhësore (të folurit, të dëgjuarit, të lexuarit dhe të shkruarit).
- Forcimi i vetëbesimit për ta përdorur gjuhën shqipe në mënyrë aktive dhe funksionale.
- Përfshirja e plotë në jetën e klasës dhe të shkollës.

Qasje të rekomanduara:

- Vlerësimi fillestar (diagnostikues) i nivelit të zotërimit të gjuhës shqipe, për të kuptuar nevojat specifike dhe për të ndërtuar një plan pune të personalizuar.
- Përshtatja e materialeve mësimore, duke përdorur tekste të thjeshtuara, mjete pamore, skema dhe përkthime, kur është e nevojshme.

- Përdorimi i metodave shumëshqisore (imazhe, audio, video, objekte konkrete) për të ndihmuar në kuptimin dhe përvetësimin e fjalorit dhe të strukturave gjuhësore.
- Krijimi i fjalorthëve për çdo temë që trajtohet në klasë, me fjalë kyç dhe me shembuj përdorimi.
- Ndërtimi i teksteve të shkurtuara dhe të modeluara, që ndihmojnë nxënësit të mësojnë strukturën e fjalisë, lidhëzat, kohët dhe ndërtimin e paragrafëve.
- Mbështetja me punë individuale apo në çifte (në klasë ose jashtë saj), duke përfshirë bashkëmoshatarë që mund të ndihmojnë si “mentorë gjuhësorë”.
- Ofrimi i kohës shtesë për detyra me shkrim dhe për prezantime, si dhe vlerësimi i progresit, jo vetëm i nivelit përfundimtar.
- Përdorimi i platformave digjitale për ushtrime shtesë, si fjalorë interaktivë, video informuese në shqip, apo aplikacione për të përmirësuar shqiptimin dhe drejtshkrimin.

Shënim. Në udhëzuesit kurrikularë për lëndën e gjuhës shqipe do të përshkruhen me hollësi veprimtari praktike për zbatimin e metodave të mësimdhënies.

VIII. VLERËSIMI

Vlerësimi i nxënësit është një proces i rëndësishëm i mësimdhënies dhe ndikon drejtpërdrejt në përmirësimin e saj. Ai synon të matë shkallën e arritjes së kompetencave të përcaktuara në programin lëndor. Qëllimi i vlerësimit nuk kufizohet vetëm te vendosja e notës dhe nuk përmbyllet me

të. Vlerësimi bazohet tërësisht në rezultatet e të nxënës të parashikuara në programin e lëndës dhe mësuesi nuk duhet të vlerësojë nxënësit për përmbajtje që nuk janë pjesë e programit. Objekt i vlerësimit nuk janë vetëm njohuritë dhe aftësitë, por edhe vlerat dhe qëndrimet që zhvillon nxënësi. Mësuesi harton dhe përdor teknika dhe instrumente të ndryshme vlerësimi dhe i ndihmon nxënësit të zhvillojnë vetë praktika vlerësuese për të nxitur reflektimin dhe të nxënës e pavarur.

Disa nga mënyrat e vlerësimit në lëndën e gjuhës shqipe janë:

- *Prezantimi me gojë*: Kjo mënyrë vlerësimi ndihmon nxënësin që të përzgjedhë dhe të sintetizojë materialet e ndryshme, të krijojë ose të mbajë qëndrim, si dhe të zhvillojë shkathtësitë e të folurit në publik.
- *Shkrimi i teksteve përshkruese dhe rrëfyese*: Kjo mënyrë vlerësimi i ndihmon nxënësit që të kërkojnë, të planifikojnë, të organizojnë dhe të redaktojnë shkrimet e tyre. Mësuesi vendos se për cilat punë me shkrim (të paktën dy gjatë një viti) t'i vlerësojë të gjithë nxënësit me notë. Sugjerohen esetë. Për shkrimet e tjera, mësuesi mund të vlerësojë grupe nxënësish. Vlerësimi përfshin të gjithë procesin e të shkruarit, jo vetëm produktin përfundimtar.
- *Lexime dhe studime tekstesh të llojeve të ndryshme*: Kjo mënyrë vlerësimi bën të mundur që mësuesi të vlerësojë strategjitë e të lexuarit që përdor nxënësi për të përftuar kuptimin e tekstit, si dhe aftësitë e tij për të analizuar, për të sintetizuar dhe për të gjykuar për tekstin.
- *Punime ushtrimesh praktike*: Kjo mënyrë krijon mundësi për vlerësimin e aftësive të nxënësve për të zbatuar në mënyrë të saktë njohuritë gjuhësore në kontekste konkrete.
- *Zhvillimi i një projekti*: Kjo mënyrë vlerësimi ndihmon nxënësit që të bashkëpunojnë me të tjerët, të hulumtojnë në burime të ndryshme informacioni, të lidhin njohuritë me jetën reale, të zgjidhin probleme, të krijojnë dhe të prezantojnë në mjedise publike.
- *Testime*: Kjo mënyrë vlerësimi ndihmon nxënësin të përsërisë dhe të sintetizojë njohuritë dhe aftësitë lëndore. Mësuesi planifikon testime me shkrim për blloqe të gjera orësh mësimore duke përfshirë një ose më shumë kapituj.

Vlerësimi mund të bëhet individual ose në grup. Nxënësi vlerësohet me notë nëpërmjet demonstrimit të arritjeve të tij me gojë, me shkrim ose përmes produkteve të ndryshme, si: shkrime, analiza, zbatim njohurish në kontekste të reja etj. Në rastin e punës në grup, mësuesi përcakton peshën që ka nota për grupin në tërësi dhe për secilin nxënësi individualisht.

8.1. Shembuj të niveleve të arritjes për vlerësimin e rezultateve të të nxënit

Në këtë pjesë jepen *dy shembuj orientues* të niveleve të arritjes për dy rezultate të nxëni, me qëllim që të ofrohet një ide e përgjithshme për mënyrën e përshkallëzimit të arritjeve të nxënësve. Këta shembuj mund të shërbejnë si pikënisje për mësuesin në ndërtimin e kritereve të vlerësimit të nxënësve.

Shembull 1. Rezultati i të nxënit: Nxënësi analizon nivelin e kohezionit dhe të koherencës në tekste të ndryshme.			
Niveli i arritjes: Shumë mirë	Niveli i arritjes: Mirë	Niveli i arritjes: Mjaftueshëm	Niveli i arritjes: Dobët
Nxënësi analizon lidhjet logjike dhe gjuhësore midis pjesëve të tekstit, identifikon me shembuj konkretë mjetet e kohezionit dhe mënyrat e organizimit të ideve, si dhe jep gjykim kritik për efektivitetin e tyre.	Nxënësi dallon qartë lidhjet ndërmjet paragrafëve dhe brenda tyre, përmend disa nga mjetet e përdorura për kohezion dhe përshkruan në mënyrë të përgjithshme nëse rrjedhja e ideve është logjike dhe e qartë.	Nxënësi dallon vetëm lidhjet më të dukshme midis pjesëve të tekstit, përmend një ose dy elemente të kohezionit.	Nxënësi ka vështirësi të kuptojë si lidhen pjesët e tekstit; nuk dallon elementet që mundësojnë lidhjen logjike të ideve dhe jep një gjykim sipërfaqësor ose të paargumentuar për organizimin e tekstit.
Shembull 2. Rezultati i të nxënit: Nxënësi përdor mjete pamore (grafikë, tabela, foto) për të përforcuar mesazhin			
Niveli i arritjes: Shumë mirë	Niveli i arritjes: Mirë	Niveli i arritjes: Mjaftueshëm	Niveli i arritjes: Dobët

Nxënësi zgjedh dhe përdor në mënyrë krijuese dhe funksionale mjete pamore të përshtatshme për temën dhe audiencën, duke i integruar ato natyrshëm për të rritur qartësinë dhe ndikimin e mesazhit.	Nxënësi përdor mjete pamore të përshtatshme që mbështesin idetë kryesore, edhe pse mund të mos jenë tërësisht të harmonizuara me stilin apo kontekstin e prezantimit.	Nxënësi përfshin disa elemente pamore, por ato janë ose të kufizuara, ose të vendosura sipërfaqësisht, pa e përforcuar qartë mesazhin.	Nxënësi përdor pak ose aspak mjete vizuale, ose i përdor ato në mënyrë të papërshtatshme, pa ndikim real mbi qartësinë ose forcën e mesazhit.
--	---	--	---

Shënim. Në udhëzuesit kurrikularë për lëndën e gjuhës shqipe do të përshkruhen nivelet e arritjes për vlerësimin e rezultateve të të nxënit.

IX. BURIMET DHE MATERIALET MËSIMORE

Burimet dhe materialet mësimore janë të gjitha mjete që përdoren në procesin e mësimdhënies dhe të të nxënit për të mbështetur përvetësimin e kompetencave gjuhësore dhe të kompetencave kyç. Ato përfshijnë si burime të shtypura dhe digjitale, ashtu edhe mjete pamore, dëgjimore dhe praktike, të cilat ndihmojnë në përmbushjen e rezultateve të të nxënit dhe në aktivizimin e nxënësve në mënyrë të kuptimshme e të angazhuar. Dobitë kryesore të burimeve të të nxënit janë:

- Pasurimi i cilësisë së mësimdhënies dhe nxitja e nxënësve për të mësuar.
- Lehtësimi i procesit të të kuptuarit të njohurive dhe të koncepteve gjuhësore ose i procesit të përmbushjes së rezultateve të të nxënit.
- Sigurimi i qartësisë dhe i saktësisë në paraqitjen dhe përpunimin e informacionit.
- Nxitja e përfshirjes aktive të nxënësve në të katër aspektet e gjuhës: të dëgjuarit, të folurit, të lexuarit dhe të shkruarit.
- Mbështetja e mësimi gjithëpërfshirës dhe të personalizuar, duke respektuar nevojat dhe stilet e ndryshme të të nxënit.
- Sigurimi i ruajtjes dhe i transferimit të njohurive dhe të aftësive gjuhësore.

Burimet dhe materialet mësimore që mund të përdoren në lëndën e gjuhës shqipe, janë:

- Teksti shkollor (së bashku me fletoren e punës), i cili është një nga materialet mësimore që mund të përdoren në orën e mësimi.
- Tekste të tjera letrare dhe joletrare në bibliotekën e shkollës.
- Fjalorë dhe udhëzues gramatikorë dhe drejtshkrimorë (kryesisht online).
- Burime digjitale: platforma interaktive, video edukative, regjistrime zanore, faqe interneti për lexim dhe shkrim, aplikacione gjuhësore etj.
- Materiale të krijuara nga mësuesi: fletë pune, kartela gjuhësore, ushtrime për diktimit ose redaktim, pjesë për përpunim, pyetësorë, modele tekstesh etj.
- Punime të nxënësve, si p.sh.: ditarë leximi, punë me shkrim, postera, prezantime etj.
- Mjete pamore: tabela për strukturën e tekstit ose klasat e fjalëve, ilustrime, skema, diagrame, grafikë etj.

Mësuesi zgjedh burimet dhe materialet në varësi:

- të rezultateve të të nxënësit që synon të përmbushë;
- të mjedisit të klasës dhe veçorive të nxënësve;
- të përmbajtjes tematike dhe të llojit të tekstit që punohet;
- të nevojës për larmi, ndihmë vizuale ose gjuhësore, ose për zgjidhje praktike.

9.1. Përdorimi i teknologjisë në lëndën e gjuhës shqipe

Përdorimi i teknologjisë në lëndën e gjuhës shqipe shërben si mjet mbështetës për të përmirësuar cilësinë e të nxënësit, për të rritur motivimin e nxënësve dhe për të zgjeruar burimet e të nxënësit përtej tekstit shkollor. Teknologjia ndihmon në zhvillimin e kompetencave gjuhësore përmes mjeteve ndërvepruese, mjediseve bashkëpunuese dhe formave të reja të krijimit dhe të përpunimit të teksteve.

Disa nga format e përshtatshme të përdorimit të teknologjisë në procesin mësimor përfshijnë:

- përdorimin e platformave digjitale për lexim dhe ushtrime gjuhësore (fjalëkryqe, kuize, redaktime online);
- leximin e teksteve online dhe ndarjen e përmbledhjeve përmes forumeve digjitale;
- dëgjimin e teksteve audio dhe shikimin e materialeve video për zhvillimin e të kuptuarit në dëgjim dhe të të folurit;

- përdorimin e mjeteve për bashkëpunim në kohë reale (si *Google Docs* ose *Padlet*) për redaktimin dhe krijimin në grup;
- kërkimin online për burime të përshtatshme informacioni, duke nxitur vlerësimin kritik dhe përdorimin etik të tyre.

Përveç këtyre mjeteve, inteligjenca artificiale (IA) mund të përdoret në mënyrë të kufizuar dhe të qëllimshme, nën udhëzimin e mësuesit, për të mbështetur procesin mësimor. Ajo mund të ndihmojë:

- përmirësimin e teksteve të shkruara nga nxënësit përmes sugjerimeve për strukturë, drejtshkrim dhe stil;
- zhvillimin e mendimit kritik përmes analizës së përgjigjeve të IA-së dhe dallimit të fakteve nga opinionet;
- ushtrimin e shkrimit të argumentuar përmes krahasimit të formulimeve të ndryshme dhe diskutimit për saktësinë dhe koherencën e tyre;
- rritjen e ndërgjegjësimit për përdorimin e përgjegjshëm të burimeve digjitale.

Mësuesi kujdeset që përdorimi i teknologjisë dhe i IA-së të mos jetë një qëllim në vetvete, por një mjet për zhvillimin e kompetencave gjuhësore dhe të kompetencave kyç të nxënësve. Ai siguron që kjo teknologji të përdoret në mënyrë të përshtatshme për moshën dhe nivelin e nxënësve, duke ndërtuar një kulturë digjitale etike, kritike dhe të vetëdijshme.

9.2. Roli i bibliotekës së shkollës

Biblioteka e shkollës është një burim i rëndësishëm për të nxitur dhe për të mbështetur zhvillimin e kompetencave gjuhësore të nxënësit e klasës së dhjetë. Ajo luan rol në ndërtimin e zakonit të leximit, në zhvillimin e të kuptuarit të thellë të teksteve dhe në përdorimin kritik të informacionit.

Në lëndën e gjuhës shqipe, biblioteka mbështet nxënësit:

- për të zhvilluar shprehje të leximit të rregullt, për qëllime mësimore dhe personale;
- për të përmirësuar të kuptuarit dhe analizën e teksteve të ndryshme;
- për të mësuar të hulumtojnë, të vlerësojnë dhe të përdorin informacionin me përgjegjësi;
- për të ndërtuar mendim kritik përmes krahasimeve ndërtëkstore dhe reflektimeve për përmbajtjen;
- për të nxitur krijimin gjuhësor (shkrim përshkrues, rrëfim, analizë, ese argumentuese etj.).

Biblioteka u ofron nxënësve mjedise dhe mjete:

- për akses të drejtpërdrejtë në literaturë të larmishme (librat jashtëshkollorë, materiale digjitale, artikuj informativë etj.);
- për zhvillimin e aftësive kërkimore në bashkëpunim me mësuesin e gjuhës shqipe;
- për mbështetjen në projektet e pavarura ose në grup që lidhen me leximin, analizën ose krijimin gjuhësor;
- për përdorimin e formateve moderne të komunikimit, si: *blogje*, postime, recensime apo publikime me shumë media;
- etj.

Për më tepër, përmes përdorimit të burimeve digjitale të bibliotekës, nxënësit mësojnë:


- të formulojnë pyetje kërkimore të qarta dhe të fokusuara;
- të punojnë me tekste dhe burime në gjuhë të ndryshme;
- të përgatisin prezantime ose ese me bazë kërkimore për tema të përzgjedhura në bashkëpunim me mësuesin.

Shënim. Në udhëzuesit kurrikularë për lëndën e gjuhës shqipe do të përshkruhet më hollësisht përdorimi i burimeve dhe i materialeve mësimore përfshirë teknologjinë.

X. REKOMANDIME PËR ZBATUESIT E PROGRAMIT

Programi i gjuhës shqipe bazohet në Kornizën Kurrikulare të Arsimit Parauniversitar, në kurrikulën bërthamë, në planin mësimor të gjimnazit dhe në rekomandimet më të fundit të Bashkimit European për arsimin. Si i tillë, ky dokument u shërben mësuesve të gjuhës shqipe, autorëve të teksteve shkollore, hartuesve të testeve kombëtare, prindërve dhe vetë nxënësve, si një udhëzues për përmbajtjen, organizimin dhe zhvillimin e procesit mësimor.

Kjo rubrikë përmban disa rekomandime praktike për zbatuesit e programit, me synimin që të sigurohet efektiviteti i zbatimit të tij dhe kontributi i të gjitha palëve të përfshira në përmbushjen e qëllimeve të lëndës së gjuhës shqipe, duke nxitur përdorimin e metodave bashkëkohore, përzgjedhjen e materialeve të përshtatshme, zhvillimin e kompetencave gjuhësore dhe përfshirjen aktive të nxënësve në procesin mësimor.



Rekomandime për mësuesit

- Planifikoni mësimin në funksion të zhvillimit të kompetencave gjuhësore dhe të kompetencave kyç, duke u bazuar në situata nga jeta reale dhe në tekste autentike.
- Merrni në konsideratë ritmet dhe nevojat e ndryshme të nxënësve, duke ofruar mbështetje për ata që kanë vështirësi dhe për nxënësit me aftësi të kufizuara.
- Nxësi përdorimin funksional të gjuhës shqipe në kontekste të ndryshme (arsimor, qytetar, digjital, profesional), duke i ndihmuar nxënësit të kuptojnë se gjuha është një mjet për të vepruar dhe për të ndikuar.
- Zbatoni metoda të të nxënësve aktiv, bashkëpunues dhe reflektues, duke përfshirë punën me projekte, diskutimet, krijimin e teksteve me audienca reale dhe bashkëpunimin në grupe.
- Ofroni mundësi të rregullta për lexim të pavarur dhe të orientuar të teksteve të periudhave, kulturave dhe llojeve të ndryshme.
- Lidhni mësimin e gjuhës shqipe me fusha të tjera, si teknologjia, edukimi qytetar, shkencat shoqërore dhe gjuhët e huaja, për të ndërtuar një kuptim ndërdisiplinor dhe për të thelluar kompetencat e nxënësve.
- Përdorni mjete digjitale dhe IA-në, për të analizuar, për të përpunuar dhe për të krijuar tekste, duke edukuar një qasje kritike, të përgjegjshme dhe etike në përdorimin e tyre.

- Integroni qasjen socio-emocionale në mësimdhënie, duke krijuar një mjedis të sigurt dhe mbështetës, ku çdo nxënës ndihet i dëgjuar, i vlerësuar dhe i aftë për të marrë pjesë në procesin mësimor.
- Jepuni nxënësve detyra që nxisin vlerësimin e diversitetit kulturor dhe gjuhësor, zhvillimin e empatisë dhe ndërtimin e një identiteti qytetar të vetëdijshëm.
- Përdorni lloje të ndryshme vlerësimi, përfshirë vlerësimin formues, vetëvlerësimin dhe vlerësimin në grup, duke u përqendruar jo vetëm te produkti përfundimtar, por edhe te procesi i të nxënës.
- Bashkëpunoni ngushtë me prindërit dhe me mësuesit e tjerë për të mbështetur përparimin e nxënësve dhe për të ndërtuar tek ata kulturën e leximit.

Rekomandime për autorët e teksteve shkollore

- Hartoni tekste shkollore që pasqyrojnë qasjen me kompetenca, duke ndërtuar njohuritë dhe aftësitë e nevojshme për përdorimin funksional dhe të ndërgjegjshëm të gjuhës në situata të ndryshme komunikimi.
- Përzgjidhni tekste ose fragmente me përmbajtje të larmishme, që u përkasin llojeve, periudhave, kulturave dhe stileve të ndryshme, në mënyrë që të pasurojnë përvojën gjuhësore të nxënësve.
- Siguroni në tekstet shkollore ushtrime dhe pyetje që nxisin të menduarit kritik, interpretimin, vlerësimin dhe krijimin e teksteve të reja, në përputhje me moshën e nxënësve.
- Integroni aktivitete dhe burime që lidhin përmbajtjet e gjuhës shqipe me fusha të tjera të të nxënës (p.sh., edukimi qytetar, teknologjia, historia, arti), për të forcuar qasjen ndërdisiplinore dhe zhvillimin e kompetencave kyç.
- Ofroni modele tekstesh të shkurtra e të gjata që synojnë zhvillimin e aftësive për të shkruar për qëllime të ndryshme dhe në forma të ndryshme.
- Përfshini udhëzime të qarta për shkrimin e teksteve gjatë gjithë procesit të të shkruarit (planifikim, draftim, rishikim, redaktim) për të ndihmuar nxënësit të shkruajnë në mënyrë të strukturuar dhe të pavarur.

- Përdorni ilustrime dhe mjete grafike që lehtësojnë të kuptuarit e strukturave gjuhësore dhe organizimin e përmbajtjes së teksteve, duke shmangur zbukurimet e panevojshme.
- Përfshini ushtrime që përdorin teknologjinë në mënyrë kritike dhe krijuese, përfshirë IA (inteligjencën artificiale), në përputhje me qëllimet e lëndës dhe etikën digjitale.
- Jepni hapësirë për vetëvlerësim, reflektim dhe punë në grup në tekstet shkollore.
- Siguroni që tekstet shkollore të jenë gjithëpërfshirëse, të përshtatshme për diversitetin kulturor e gjuhësor dhe për aftësitë e nxënësve, duke shmangur stereotipet dhe duke respektuar parimet e barazisë.

Rekomandime për hartuesit e testeve kombëtare

- Hartoni teste që vlerësojnë jo vetëm njohuritë, por, mbi të gjitha, aftësitë për të përdorur gjuhën në mënyrë funksionale në kontekste reale komunikimi.
- Sigurohuni që pyetjet në test të përfshijnë nivel të lartë të të menduarit: analizë, vlerësim, argumentim dhe krijim të përmbajtjeve të reja.
- Përdorni tekste autentike dhe të larmishme që lidhen me tema të njohura për nxënësit dhe që nxisin reflektim, ndërveprim dhe qëndrime qytetare.
- Respektoni balancën mes njohurive për sistemin gjuhësor të shqipes dhe kompetencave për të komunikuar në mënyrë të saktë, të qartë dhe të ndërgjegjshme.
- Përfshini në teste lloje të ndryshme pyetjesh (me përgjigje të shkurtër, ese, analizë të tekstit, plotësime, zgjedhje të shumëfishta, krahasime) për të vlerësuar aftësi të ndryshme.
- Kujdesuni për formulimin e qartë të pyetjeve dhe të udhëzimeve, duke shmangur fjalorin e panevojshëm teknik që mund të vështirësojë kuptimin e pyetjeve.
- Sigurohuni që testet dhe pyetjet të jenë gjithëpërfshirëse, të ndjeshme ndaj diversitetit gjuhësor, kulturor dhe socio-ekonomik të nxënësve.

- Përfshini pyetje që lidhen me përpunimin e informacionit nga burime të ndryshme, duke vlerësuar edhe aftësinë për të cituar, për të sintetizuar dhe për të interpretuar në mënyrë kritike.
- Zhvilloni modele orientuese testesh dhe fletëvlerësime të qarta që mund të përdoren nga mësuesit gjatë vitit për përgatitjen graduale të nxënësve për vlerësimin përfundimtar.
- Siguroni koherencë mes përmbajtjes së testit, qëllimeve të programit dhe metodologjisë së mësimdhënies së rekomanduar në dokumentet kurrikulare.

Rekomandime për prindërit

- Inkurajoni fëmijët të kuptojnë rëndësinë e gjuhës shqipe jo vetëm si lëndë shkollore, por si një mjet për të shprehur veten, për të zhvilluar identitetin kombëtar, për të ndërtuar mendim kritik dhe për të marrë pjesë aktive në jetën shoqërore dhe profesionale.
- Nxitni leximin e rregullt në shtëpi, jo vetëm të teksteve të detyrueshme shkollore, por edhe të librave, eseve, artikujve dhe materialeve që lidhen me interesat vetjakë të fëmijës.
- Diskutoni me fëmijët për tekstet që lexojnë në shkollë apo jashtë saj, duke i nxitur të argumentojnë mendimet dhe të reflektojnë për temat që i prekin.
- Promovoni një qëndrim pozitiv ndaj përpjekjes dhe të nxënësve përmes gabimeve. Lavdëroni përpjekjet për të përmirësuar të folurit, të shkruarit dhe të kuptuarit e leximit.
- Bashkëpunoni me mësuesit e gjuhës shqipe, duke u interesuar për përparimin e fëmijës, për përmbajtjen e programit dhe për mënyrat se si mund ta mbështetni në shtëpi.
- Siguroni një mjedis në shtëpi që e nxit të folurin, leximin dhe të menduarit, përmes bisedave, ekspozimit ndaj mediave cilësore në gjuhën shqipe dhe përdorimit të teknologjisë.
- Ndhmoni fëmijën të organizojë kohën për përgatitje të pavarur, për projekte krijuese dhe për detyra që kërkojnë hulumtim, duke e udhëzuar të përdorë burime të besueshme dhe të respektojë të drejtat e autorit.

- Mbështetni zhvillimin e fëmijës si lexues i pavarur, si qytetar i ndërgjegjshëm dhe si përdorues kompetent i gjuhës shqipe, që është një pjesë e identitetit dhe e trashëgimisë kombëtare.

Rekomandime për nxënësit

- Merrni pjesë aktive në orët e gjuhës shqipe duke folur, duke lexuar, duke shkruar në mënyrë të qartë dhe krijuese, si dhe duke ndarë mendimet tuaja për temat që trajtohen.
- Shfrytëzoni tekstet e lëndës së gjuhës shqipe jo vetëm për të mësuar rregulla gjuhësore, por edhe për të kuptuar botën përreth, për të zhvilluar mendimin kritik dhe për të formuar qëndrime të vetëdijshme ndaj realitetit shoqëror.
- Lexoni rregullisht materiale të ndryshme, duke u përpjekur të kuptoni jo vetëm përmbajtjen, por edhe qëllimin, stilin dhe ndikimin e tyre.
- Praktikoni shkrimin në forma dhe në lloje të ndryshme, duke marrë parasysh audiencën, qëllimin, temën dhe kontekstin e komunikimit.
- Angazhohuni në projekte të përbashkëta dhe në veprimtari bashkëpunuese që lidhen me gjuhën dhe komunikimin, ku mund të ushtroni aftësitë e kërkimit, të shprehjes dhe të prezantimit.
- Shprehni mendimet tuaja në mënyrë të qartë dhe të argumentuar, duke respektuar mendimet e të tjerëve dhe duke ndërtuar një dialog të frytshëm në klasë.
- Përdorni mjetet digjitale dhe burimet online për të përforcuar njohuritë tuaja gjuhësore, për të ushtruar veten në detyra të ndryshme, për të kërkuar informacion të besueshëm dhe për të zhvilluar projekte krijuese.
- Reflektoni për përparimin tuaj në të gjitha kompetencat e gjuhës: të folurit, të dëgjuarit, të lexuarit dhe të shkruarit, duke kërkuar mbështetje kur është e nevojshme dhe duke ndjekur udhëzimet e mësuesit për përmirësim.
- Kujdesuni për gjuhën tuaj, flisni dhe shkruani me korrektësi, duke respektuar normat e shqipes standarde dhe duke pasuruar vazhdimisht fjalorin tuaj.
- Vlerësoni gjuhën shqipe si një pjesë të rëndësishme të identitetit tuaj dhe si një pasuri personale që do t'ju shërbejë në arsim, në punë dhe në jetën shoqërore.

XI. NDRYSHIMET PËRMBAJTJESORE

Krahasuar me programin e mëparshëm të gjuhës shqipe në klasën e dhjetë, në këtë program:

1. Kanë ndryshuar kompetencat kyç në përputhje me risitë në Kornizën Kurrikulare të Arsimit Parauniversitar. Këto kompetenca janë:
 - ✓ Kompetenca e komunikimit në gjuhën amtare.
 - ✓ Kompetenca e komunikimit në gjuhë të huaja.
 - ✓ Kompetenca në matematikë, shkencë, teknologji dhe inxhinieri.
 - ✓ Kompetenca digjitale.
 - ✓ Kompetenca personale, shoqërore dhe e të nxënit.
 - ✓ Kompetenca qytetare.
 - ✓ Kompetenca e sipërmarrjes.
 - ✓ Kompetenca për vetëdijen dhe shprehjen kulturore.
2. Rezultatet e të nxënit të kompetencave kyç janë dhënë për klasë (jo për shkallë).
3. Kanë ndryshuar temat ndërkurrikulare, për të cilat në program janë ofruar disa shembuj të trajtimit të tyre në lëndën e gjuhës shqipe. Temat ndërkurrikulare janë:
 - ✓ Identiteti kombëtar.
 - ✓ Qytetaria aktive dhe sipërmarrja.
 - ✓ Shëndeti mendor e fizik dhe siguria.
 - ✓ Zhvillimi i qëndrueshëm.
 - ✓ Teknologjia, shoqëria dhe media.
4. Kanë ndryshuar kompetencat e lëndës:

- ✓ Të dëgjuarit dhe të folurit janë së bashku në një kompetencë “Të dëgjuarit dhe të folurit për qëllime të ndryshme”, pasi të dëgjuarit dhe të folurit ndodhin në të njëjtën situatë komunikimi: nuk mund të ketë dialog, debat apo diskutim efektiv pa dëgjim aktiv dhe pa reagim përmes të folurit. Të dyja konsiderohen si pjesë e komunikimit gojor.
 - ✓ Të shkruarit për qëllime të ndryshme është ndryshuar në emërtimin “Krijimi i teksteve të ndryshme”, pasi vihet më shumë theksi në procesin e plotë krijues, që nis nga konceptimi i idesë, planifikimi, përzgjedhja e formës, përdorimi i mjeteve të ndryshme gjuhësore e stilistike, deri te rishikimi, redaktimi dhe prezantimi përfundimtar.
5. Në ndarjen e kohës mësimore janë sugjeruar që 20 orë të përdoren nga mësuesi për përsëritje, testime, projekt dhe punë me shkrim. Kjo do t’i japë më shumë fleksibilitet mësuesit në planifikim, duke e bërë programin më të zbatueshëm dhe në përshtatje me nevojat e nxënësve.
 6. Gjatë klasës së dhjetë nxënësit studiojnë veçoritë përmbajtjesore, strukturore dhe stilistikore të teksteve përshkruese dhe rrëfyese. Kjo do t’i ndihmojë të bëjnë një kalim më “të butë” nga arsimi bazë në arsimin e mesëm të lartë, do të krijojë mundësi që nxënësit të thellohen në interpretimin, analizën, gjykimin dhe vlerësimin e teksteve, si dhe do të shmangë përsëritjet e panevojshme vit pas viti.
 7. Në tekstet që nxënësit zbatojnë aftësitë e të dëgjuarit janë përfshirë edhe tekste digjitale si: *blogje, podcast-e*. Janë shtuar disa njohuri tek të dëgjuarit dhe të folurit, si: paragjykimet dhe manipulimet në komunikim; etika e dëgjimit dhe e komunikimit në mjediset online; zgjedhja e fjalëve dhe e mjeteve stilistike. Gjithashtu janë shtuar disa aftësi që kanë lidhje me të dëgjuarit në hapësirën digjitale.
 - Te kompetenca e të lexuarit, përveç se është përcaktuar vetëm studimi i teksteve përshkruese dhe i teksteve rrëfyese, janë shtuar njohuri: *Përdorimi i teknikave të leximit kritik: dallimi ndërmjet fakteve dhe opinioneve, identifikimi i qëllimit dhe qëndrimit të autorit, analiza e nëntekstit dhe e ndikimit të gjuhës në mesazh; Etika e leximit dhe e përdorimit të informacionit: respektimi i të drejtës së autorit, citimi korrekt i burimeve, shmangia e plagjiaturës dhe përdorimi etik i informacionit, veçanërisht në mjedise digjitale e mediatike.*
 - Te kompetenca “Krijimi i teksteve të ndryshme” është përcaktuar që nxënësit gjatë klasës së dhjetë shkruajnë vetëm tekste përshkruese dhe tekste rrëfyese, janë shtuar tek aftësitë disa elemente që lidhen me përdorimin e teknologjisë në procesin e krijimit të teksteve.
 8. Te “Përdorimi i drejtë i gjuhës”:
 - a) janë hequr:

- ✓ Emrat që kanë të njëjtën temë, si në njëjës, ashtu edhe në shumës.
- ✓ Emrat që përdoren vetëm në numrin njëjës. Emrat që përdoren vetëm në numrin shumës.
- ✓ Foljet kalimtare dhe jokalistare.
- ✓ Format e pashtjelluara foljore. Pjesorja e foljes.
- ✓ Mbiemrat cilësorë dhe mbiemrat marrëdhëniorë.
- ✓ Shumësi i mbiemrave. Përdorimi në shumës i mbiemrave që përcaktojnë emra mashkullorë me shumësin me - e, - ra dhe me -a.
- ✓ Përshtatja, në vetë dhe në numër, e kallëzuesit foljor dhe e këpujës me kryefjalën. Përshtatja e gjymtyrës emërore me kryefjalën.
- ✓ Fjalitë dëftore. Rendi i gjymtyrëve në fjalitë dëftore.
- ✓ Fjalitë e paplotë. Fjalitë e paplota kontekstuale, situative.

b) Janë shtuar:

- ✓ Sinonimet kontekstuale. Vargjet sinonimike. Antonimet kontekstuale.
- ✓ Shprehjet frazeologjike. Kuptimet e figurshme të fjalëve.
- ✓ Drejtshkrimi i citimeve dhe i bibliografisë.
- ✓ Drejtshkrimi në dialogë.
- ✓ Drejtshkrimi i takimit të dy zanoreve (zanore të njëjta ose jo) ose bashkëtingëlloreve të njëjta ose jo.
- ✓ Njohuri stilistike: Gjuha e folur dhe gjuha e shkruar. Dialogu dhe monologu. Parafrasa. Koherenca dhe kohezioni.